



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.35**

**27 mars**

**2009**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

Dekret nr.6114 datë 26.3.2009	Për shpallje të ligjit nr.10 100, datë 26.3.2009 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin e Atlantikut të Veriut”. .....	1893
Dekret nr.6115 datë 26.3.2009	Për shpallje të ligjit nr.10 101, datë 26.3.2009 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut për statusin e forcave të tyre”... ..	1893
Dekret nr.6116 datë 26.3.2009	Për shpallje të ligjit nr.10 102, datë 26.3.2009 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes për statusin e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, të përfaqësuesve kombëtarë dhe personelit ndërkombëtar”” .....	1894
Dekret nr.6117 datë 26.3.2009	Për shpallje të ligjit nr.10 103, datë 26.3.2009 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Marrëveshjen për statusin e misionëve dhe të përfaqësuesve të shteteve të treta në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut”” .....	1894
Dekret nr.6118 datë 26.3.2009	Për shpallje të ligjit nr.10 104, datë 26.3.2009 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Protokollin për statusin e shtabeve ushtarake ndërkombëtare, të ngritura në përputhje me Traktatin e Atlantikut të Veriut”” .....	1895
Urdhër i MASH nr.36, datë 24.2.2009	Për miratimin e paketës informuese Altertekst 2009 .....	1895

**DEKRET**  
**Nr.6114, datë 26.3.2009**

**PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe 4, si dhe nenit 93 të Kushtetutës,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

Shpalljen dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit nr.10 100, datë 26.3.2009 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin e Atlantikut të Veriut”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Bamir Topi**

**DEKRET**  
**Nr.6115, datë 26.3.2009**

**PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe 4, si dhe nenit 93 të Kushtetutës,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

Shpalljen dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit nr.10 101, datë 26.3.2009 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut për statusin e forcave të tyre””.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Bamir Topi**

**DEKRET**  
**Nr.6116, datë 26.3.2009**

**PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe 4, si dhe nenit 93 të Kushtetutës,

**DEKRETOJ:**

**Neni 1**

Shpalljen dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit nr.10 102, datë 26.3.2009 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes për statusin e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, të përfaqësuesve kombëtarë dhe personelit ndërkombëtar””.

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Bamir Topi**

**DEKRET**  
**Nr.6117, datë 26.3.2009**

**PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe 4, si dhe nenit 93 të Kushtetutës,

**DEKRETOJ:**

**Neni 1**

Shpalljen dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit nr.10 103, datë 26.3.2009 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes për statusin e misioneve dhe të përfaqësuesve të shteteve të treta në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut””.

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Bamir Topi**

**DEKRET**  
**Nr.6118, datë 26.3.2009**

**PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe 4, si dhe nenit 93 të Kushtetutës,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

Shpalljen dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit nr.10 104, datë 26.3.2009 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Protokollin për statusin e shtabeve ushtarake ndërkombëtare, të ngritura në përputhje me Traktatin e Atlantikut të Veriut””.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Bamir Topi**

**URDHËR**  
**Nr.36, datë 24.2.2009**

**PËR MIRATIMIN E PAKETËS INFORMUESE ALTERTEKST 2009**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 106 dhe 107 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozim të Komitetit të Miratimit të Teksteve:

**URDHËROJ:**

I. Miratimin e Paketës informuese Altertekst 2009 e cila përmban:

1. Kërkesën për tekste shkollore;
2. Specifikimet teknike të teksteve të kërkuara;
3. Tekste me më shumë se dy alternativa që do të përdoren në vitin mësimor 2009-2010.
4. Udhëzime të përgjithshme për përdorimin e teksteve në shkolla në Republikën e Shqipërisë;
5. Dokumentet që botuesi dorëzon për miratim teksti;
6. Kriteret e vlerësimit të përmbajtjes;
7. Vlerësimin e çmimit, vlerësimin e përgjithshëm dhe miratimin;
8. Koeficientet e formulës së vlerësimit së çmimit;
9. Kontratën;
10. Deklaratën për autorësinë e tekstit;
11. Deklaratën për pajtueshmërinë me rregullin e konfliktit të interesit
12. Deklaratën për kopirajtin e tekstit;
13. Deklaratën për specifikimet teknike të tekstit;
14. Deklaratën për çmimin e tekstit.

II. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Menaxhimit të Përditshëm, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Planifikimit Buxhetor dhe Komisioni i Miratimit të Teksteve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
**Fatos Beja**  
1895

PAKETA INFORMUESE  
ALTERTEKST 2009

1. KËRKESË PËR TEKSTE SHKOLLORE

Në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.260, datë 18.04.2007, “Për botimin, shtypjen dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të sistemit arsimor parauniversitar”, i ndryshuar dhe të Urdhrit Nr 30, datë 12.2.2009, “Për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit për Miratimin e Teksteve Shkollore”, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) shpall kërkesën për tekste shkollore, për vitin shkollor (2009-2010), si më poshtë:

I. PËR TEKSTET QË DO TË KONKURROJNË

1. Për pajisjen e nxënësve më tekste shkollore, për vitin shkollor 2009-2010, do të shpallet konkursi për tekstet e arsimit parauniversitar, të certifikuar, që janë në përdorim, me një dhe dy alternativa, si dhe për titujt e teksteve të pabotuar deri tani, sipas Tabelës 1. Për vitin shkollor 2009-2010 përjashtohen nga konkurrimi tekstet shkollorë të certifikuar, që janë në përdorim me tre dhe më shumë alternativa, sipas Tabelës 2.

2. Ftohen të gjitha shtëpitë botuese të paraqesin variantet e tyre të teksteve për miratim dhe, më pas, të marrin pjesë në tregun konkurrues, i cili do të funksionojë në përputhje me vendimin e mësipërm. Secili nga botuesit e interesuar mund të marrë, pranë sekretarisë së Komisionit të Miratimit të Teksteve (KMT) në MASH, Paketën Informuese ALTERTEKST 2009, me hollësitë e nevojshme për kushtet dhe kërkesat për të aplikuar, si dhe materiale të tjera.

3. Nuk pranohet pjesëmarrja në konkurrim për rastet që bien ndesh me rregullin e konfliktit të interesit sipas paragrafit përkatës në Paketën Informuese ALTERTEKST 2009. Përjashtohen nga kjo pjesëmarrje, shtëpitë botuese që kanë shkëlur kontratat që ata kanë lidhur me MASH, gjatë pjesëmarrjes së tyre në ALTERTEKST-et e mëparshme. Gjithashtu përjashtohen shtëpitë botuese që kanë refuzuar lidhjen e kontratës, të parashikuar në paragrafët e caktuara të Paketave Informuese në ALTERTEKST-et e mëparshme.

4. Dorëzimi nga botuesit i teksteve sipas titujve të Tabelës 1, do të bëhet në MASH, nga data 20 deri në 27 prill 2009, brenda orës 16:30, nga secili pjesëmarrës veç e veç, sipas radhës. Ofertat e paraqitura jashtë këtyre afateve ose që nuk përmbushin kërkesat e përshkruara në Paketën Informuese ALTERTEKST 2009, nuk do të shqyrtohen.

II. PËR TEKSTET QË DO TË RIBOTOHEN

1. Për tekstet shkollorë, të certifikuar, që janë në përdorim, të cilët janë me një, dy, tre e më shumë alternativa, do të rilidhen kontratat e botuesve përkatës me MASH si vijon:

a) Tekstet, për të cilat KMT nuk ka vërejtje, MASH do të rilidhë kontratat me botuesit duke filluar nga data 11 prill 2009.

b) Për tekstet që do të ketë vërejtje nga KMT, MASH do të rilidhë kontratat me botuesit vetëm pasi të jenë bërë korrigjimet përkatëse, sipas afateve të mëposhtme:

i) Vërejtjet për secilin tekst botuesit do t'i marrin pranë KMT në datat 2-5 mars 2009. Këto vërejtje do të jenë në dispozicion të të gjitha DAR/ZA-ve.

ii) Dorëzimi i teksteve të korrigjuara pranë KMT do të bëhet brenda tri javëve nga dita e marrjes së vërejtjeve. Teksti i rikorrigjuar do të dorëzohet në dy kopje, i lidhur në trajtë provizore, me vrima e kapëse plastike.

iii) Rilidhja e kontratave do të bëhet vetëm për tekstet të cilat do të kenë pasqyruar vërejtjet, brenda një jave nga dorëzimi i tekstit të korrigjuar. Rilidhja e kontratave kryhet në dhjetëditëshin e parë të muajit prill 2009.

Paketa Informuese ALTERTEKST 2009, si dhe çdo material tjetër shpjegues u jepen vetëm shtëpive botuese dhe do të merren në sekretarinë e Komisionit të Miratimit të Teksteve në MASH, përkundrejt pagesës 1,000 lekë për Paketën Informuese ALTERTEKST 2009 dhe 200 lekë për çdo program mësimor, të derdhura për llogari të MASH në bankat e nivelit të dytë ose në zyrat e Postës Shqiptare.

Për çdo informacion të mëtejshëm, mund të drejtoheni në këtë sekretari ose me postë elektronike në adresën [pmilo@MASH.gov.al](mailto:pmilo@MASH.gov.al).

## 2. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË TEKSTEVE TË KËRKUARA PËR (2009-2010)

Tabela 1

Nr I	Cikli / Titulli II	Numri preventiv i faqeve III	Formati prerë (në cm.) IV	Nr. ngj. Bllokut V	Nr. ngj. kopert. VI	Lloji lidhjes VII
<b>Arsimi bazë</b>						
<b>Klasa e parë</b>						
1	Edukatë shoqërore	50	20.7x27.7	4	4	tel (2)
<b>Klasa e dytë</b>						
1	Matematika	120	20.7x27.7	4	4	ngjitje
2	Matematika - fletë pune	80	20.7x27.7	4	4	tel (2)
<b>Klasa e tretë</b>						
1	Matematika	180	20.7x27.7	4	4	ngjitje
2	Matematika - fletë pune	120	20.7x27.7	4	4	ngjitje
3	Gjuha frënge	120	20.7x27.7	4	4	ngjitje
4	Gjuha frënge - fletore pune	80	20.7x27.7	4	4	tel (2)
5	Gjuha italiane	120	20.7x27.7	4	4	ngjitje
6	Gjuha italiane - fletore pune	80	20.7x27.7	4	4	tel (2)
<b>Klasa e katërt</b>						
1	Gjuha frënge	120	20.7x27.7	4	4	ngjitje
2	Gjuha frënge - fletore pune	80	20.7x27.7	4	4	tel (2)
3	Gjuha italiane	120	20.7x27.7	4	4	ngjitje
4	Gjuha italiane - fletore pune	80	20.7x27.7	4	4	tel (2)
<b>Klasa e pestë</b>						
1	Edukata shoqërore	60	20.7x27.7	4	4	tel (2)
2	Edukim muzikor	60	20.7x27.7	2	4	tel (2)
3	Aftësim teknologjik	60	20.7x27.7	1	4	tel (2)
4	Gjuha frënge	120	20.7x27.7	4	4	ngjitje
5	Gjuha frënge - fletore pune	80	20.7x27.7	4	4	tel (2)
<b>Klasa e gjashtë</b>						
1	Gjuha shqipe	300	18.2x25.7	4	4	ngjitje
2	Biologji dhe edukim shëndetsor	120	18.2x25.7	4	4	ngjitje
3	Gjeografia	120	18.2x25.7	4	4	ngjitje
4	Edukim muzikor	60	18.2x25.7	1	4	tel (2)
5	Aftësim teknologjik	60	18.2x25.7	1	4	tel (2)
6	Edukim figurativ	60	18.2x25.7	4	4	tel (2)
7	Gjuha frënge	120	18.2x25.7	4	4	ngjitje
8	Gjuha frënge - fletore pune	90	18.2x25.7	4	4	ngjitje
9	Gjuha angleze për fillestarë (kl. 6 dhe 7)	200	18.2x25.7	4	4	ngjitje
10	Gjuha angleze - fl. pune për fill. (kl. 6 dhe 7)	150	18.2x25.7	4	4	ngjitje
11	Gjuha frënge për fillestarë (kl. 6 dhe 7)	200	18.2x25.7	4	4	ngjitje
12	Gjuha frënge - fl. pune për fill. (kl. 6 dhe 7)	150	18.2x25.7	4	4	ngjitje
13	Gjuha italiane për fillestarë (kl. 6 dhe 7)	200	18.2x25.7	4	4	ngjitje
14	Gjuha italiane - fl. pune për fill. (kl. 6 dhe 7)	150	18.2x25.7	4	4	ngjitje
<b>Klasa e shtatë</b>						
1	Gjuha shqipe	300	18.2x25.7	4	4	ngjitje
2	Edukata shoqërore	70	18.2x25.7	2	4	tel (2)
3	Edukim figurativ	60	18.2x25.7	4	4	tel (2)
4	Edukim muzikor	80	18.2x25.7	1	4	tel (2)
5	Aftësim teknologjik	80	18.2x25.8	2	4	tel (2)
6	Gjuha frënge	150	18.2x25.7	4	4	ngjitje

7	Gjuha frënge - fletore pune	120	18.2x25.7	4	4	ngjitje
8	Informatikë	80	18.2x25.7	4	4	ngjitje
<b>Klasa e tetë</b>						
1	Gjuha shqipe	250	18.2x25.7	4	4	ngjitje
2	Edukata shoqërore	60	18.2x25.7	4	4	tel (2)
3	Edukim muzikor	120	18.2x25.7	2	4	ngjitje
4	Gjuha frënge	160	18.2x25.7	4	4	ngjitje
5	Gjuha frënge - fletore pune	130	18.2x25.7	4	4	ngjitje
6	Gjuha italiane	160	18.2x25.7	4	4	ngjitje
7	Gjuha italiane - fletore pune	130	18.2x25.7	4	4	ngjitje
8	Gjuha angleze për fillestarë (kl. 8 dhe 9)	220	18.2x25.7	4	4	ngjitje
9	Gjuha angleze - fl. pune për fill. (kl. 8 dhe 9)	180	18.2x25.7	4	4	ngjitje
10	Gjuha frënge për fillestarë (kl. 8 dhe 9)	220	18.2x25.7	4	4	ngjitje
11	Gjuha frënge - fl. pune për fill. (kl. 8 dhe 9)	180	18.2x25.7	4	4	ngjitje
12	Gjuha italiane për fillestarë (kl. 8 dhe 9)	220	18.2x25.7	4	4	ngjitje
13	Gjuha italiane - fl. pune për fill. (kl. 8 dhe 9)	180	18.2x25.7	4	4	ngjitje
14	Informatikë	80	18.2x25.7	4	4	ngjitje
<b>Klasa e nëntë</b>						
1	Gjuha shqipe	300	18.2x25.7	4	4	ngjitje
2	Edukim muzikor	120	18.2x25.7	2	4	ngjitje
3	Historia	140	18.2x25.7	2	4	ngjitje
<b>Gjimnazi</b>						
<b>Viti i parë</b>						
1	Gjuhë shqipe dhe Letërsi	320	18.2x25.7	4	4	ngjitje
2	Artet (muzika, teatri, vallzimi, arti pamor)	100	18.2x25.7	4	4	ngjitje
3	Oytetari	200	18.2x25.7	4	4	ngjitje
4	Edukim për karrierën dhe aftësi për jetën	100	18.2x25.7	4	4	ngjitje
<b>Viti i tretë</b>						
1	Letërsi dhe gjuhë shqipe - drejtimi natyror	270	16.1x23.4	1	4	ngjitje
2	Letërsi dhe gjuhë shqipe - drejt. shoq. dhe i përgj.	500	16.1x23.4	1	4	ngjitje
3	Njohuri për shoqërinë - drejtimi shoqëror	180	16.1x23.4	1	4	ngjitje
4	Njohuri për ekonominë - drejt. nat., shoq., i përgjith.	268	16.1x23.4	1	4	ngjitje
5	Matematika 3.1 - drejtimi natyror dhe i përgjithshëm	392	18.2x25.7	1	4	ngjitje
6	Matematika 3.1 - drejtimi shoqëror	216	18.2x25.7	1	4	ngjitje
7	Matematika 3.2 - drejtimi natyror dhe i përgjithshëm	288	18.2x25.7	1	4	ngjitje
8	Matematika 3.2 - drejtimi shoqëror	152	18.2x25.7	1	4	ngjitje
9	Fizika - drejtimi natyror dhe i përgjithshëm	428	18.2x25.7	1	4	ngjitje
10	Fizika - drejtimi shoqëror	214	18.2x25.7	1	4	ngjitje
11	Kimia organike - drejtimi natyror dhe i përgjithshëm	244	18.2x25.7	4	4	ngjitje
12	Kimia organike - drejtimi shoqëror	176	18.2x25.7	4	4	ngjitje
13	Historia - drejtimi natyror	220	18.2x25.7	4	4	ngjitje
14	Historia - drejtimi shoqëror dhe i përgjithshëm	340	18.2x25.7	4	4	ngjitje
15	Biologjia - drejtimi natyror dhe i përgjithshëm	160	18.2x25.7	4	4	ngjitje
16	Biologjia - drejtimi shoqëror	160	18.2x25.7	4	4	ngjitje
17	Teknologjia - drejtimi natyror dhe i përgjithshëm	110	20.7x27.7	1	4	ngjitje
18	Informatika - drejtimi natyror	200	18.2x25.7	4	4	ngjitje
19	Informatika - drejtimi shoqëror dhe i përgjithshëm	200	18.2x25.7	4	4	ngjitje
20	Gjeografia - drejtimi natyror, shoqëror, i përgjithshëm	110	18.2x25.7	4	4	ngjitje
21	Gjuha frënge - drejt. nat., shoq., i përgjithshëm	230	18.2x25.7	4	4	ngjitje
22	Gjuha frënge - fl.pune, drejt.nat., shoq., i përgjith.	200	18.2x25.7	4	4	ngjitje
23	Gjuha italiane - drejt. nat., shoq., i përgjithshëm	230	18.2x25.7	4	4	ngjitje
24	Gjuha italiane - fl.pune, drejt.nat., shoq., i përgjith.	200	18.2x25.7	4	4	ngjitje

25	Gjuha gjermane - drejt. nat., shoq., i përgjithshëm	230	18.2x25.7	4	4	ngjitje
26	Gjuha gjermane - fl.pune, drejt.nat., shoq., i përgjith.	200	18.2x25.7	4	4	ngjitje
<b>Viti i katërt</b>						
1	Letërsi dhe gjuhë shqipe - drejtimi natyror	200	16.1x23.4	1	4	ngjitje
2	Letërsi dhe gjuhë shqipe - drejt. shoq. dhe i përgjith.	500	16.1x23.4	1	4	ngjitje
3	Matematika 4.1 - drejtimi natyror dhe i përgjithshëm	348	18.2x25.7	1	4	ngjitje
4	Matematika 4.2 - drejtimi natyror dhe i përgjithshëm	232	18.2x25.7	1	4	ngjitje
5	Matematika - drejtimi shoqëror	262	18.2x25.7	1	4	ngjitje
6	Fizika - drejtimi natyror dhe i përgjithshëm	422	18.2x25.7	2	4	ngjitje
7	Fizika - drejtimi shoqëror	196	18.2x25.7	2	4	ngjitje
8	Psikologjia - drejtimi shoqëror	236	16.1x23.4	1	4	ngjitje
9	Historia - drejtimi natyror	200	18.2x25.7	4	4	ngjitje
10	Historia - drejtimi shoqëror dhe i përgjithshëm	373	18.2x25.7	4	4	ngjitje
11	Kimia organike - drejtimi natyror dhe i përgjithshëm	270	18.2x25.7	4	4	ngjitje
12	Historia e artit - drejtimi shoqëror	200	18.2x25.7	4	4	ngjitje
13	Filozofia	116	16.1x23.4	1	4	ngjitje
14	Informatika - drejtimi natyror	200	18.2x25.7	4	4	ngjitje
15	Informatika - drejtimi shoqëror dhe i përgjithshëm	200	18.2x25.7	4	4	ngjitje
16	Biologjia - drejtimi natyror dhe i përgjithshëm	208	18.2x25.7	4	4	ngjitje
17	Biologjia - drejtimi shoqëror	150	18.2x25.7	4	4	ngjitje
18	Gjeografia - drejtimi nat., shoq., dhe i përgjithshëm	200	18.2x25.7	2	4	ngjitje
19	Gjuha frënge - drejt. nat., shoq., i përgjithshëm	280	18.2x25.7	4	4	ngjitje
20	Gjuha frënge - fl.pune, drejt.nat., shoq., i përgjith.	250	18.2x25.7	4	4	ngjitje
21	Gjuha italiane - drejt. nat., shoq., i përgjithshëm	280	18.2x25.7	4	4	ngjitje
22	Gjuha italiane - fl.pune, drejt.nat., shoq., i përgjith.	250	18.2x25.7	4	4	ngjitje
23	Gjuha gjermane - drejt. nat., shoq., i përgjithshëm	280	18.2x25.7	4	4	ngjitje
24	Gjuha gjermane - fl.pune, drejt.nat., shoq., i përgjith.	250	18.2x25.7	4	4	ngjitje
<b>Tituj të pakicave kombëtare</b>						
<b>Tituj të përbashkët të pakicës gre. dhe maqed.</b>						
1	Gjuha shqipe 1	40	20.7x27.7	4	4	tel (2)
2	Gjuha shqipe 2	100	20.7x27.7	4	4	ngjitje
3	Gjuha shqipe 3	240	20.7x27.7	4	4	ngjitje
4	Gjuha shqipe 4	240	20.7x27.7	4	4	ngjitje
<b>Tituj të pakicës greke</b>						
1	Gjuha greke 1	120	20.7x27.7	4	4	ngjitje
2	Gjuha greke 2	210	20.7x27.7	4	4	ngjitje
3	Gjuha greke 3	240	20.7x27.7	4	4	ngjitje
4	Gjuha greke 4	240	20.7x27.7	4	4	ngjitje
5	Gjuha greke 5	240	20.7x27.7	4	4	ngjitje
6	Gjuha greke 6	240	18.2x25.7	4	4	ngjitje
7	Gjuha greke 7	260	18.2x25.7	2	4	ngjitje
8	Gjuha greke 8	260	18.2x25.7	2	4	ngjitje
9	Gjeografi amtare 8	70	18.2x25.7	4	4	tel (2)
10	Gjuhe greke 9	240	18.2x25.7	2	4	ngjitje
11	Histori amtare 9	70	18.2x25.7	4	4	tel (2)
<b>Tituj përkthime në gjuhën greke</b>						
1	Matematika 1	120	20.7x27.7	4	4	ngjitje
2	Matematika 1 - fletë pune	80	20.7x27.7	4	4	tel (2)
3	Edukatë shoqërore 1	50	20.7x27.7	4	4	tel (2)
4	Matematika 2	120	20.7x27.7	4	4	ngjitje
5	Matematika 2 - fletë pune	80	20.7x27.7	4	4	tel (2)
6	Edukata shoqërore 2	50	20.7x27.7	4	4	tel (2)

7	Matematika 3	180	20.7x27.7	4	4	ngjitje
8	Matematika 3 - fletë pune	120	20.7x27.7	4	4	ngjitje
9	Dituri natyre 3	140	20.7x27.7	4	4	ngjitje
10	Edukatë shoqërore 3	60	20.7x27.7	4	4	tel (2)
11	Matematika 4	200	20.7x27.7	4	4	ngjitje
12	Matematika 4 - fletë pune	120	20.7x27.7	4	4	ngjitje
13	Dituri natyre 4	180	20.7x27.7	4	4	ngjitje
14	Edukata shoqërore 4	60	20.7x27.7	4	4	tel (2)
15	Edukim muzikor 4	60	20.7x27.7	2	4	tel (2)
16	Dituri natyre 5	140	20.7x27.7	4	4	ngjitje
17	Edukata shoqërore 5	60	20.7x27.7	4	4	tel (2)
18	Edukata muzikore 5	60	20.7x27.7	2	4	tel (2)
19	Aftësim teknologjik 5	60	20.7x27.7	1	4	tel (2)
20	Biologji dhe edukim shëndetësor 6	120	18.2x25.7	4	4	ngjitje
21	Historia 6	120	18.2x25.7	4	4	ngjitje
22	Gjeografia 6	120	18.2x25.7	4	4	ngjitje
23	Edukata shoqërore 6	60	18.2x25.7	2	4	tel (2)
24	Edukim muzikor 6	60	18.2x25.7	1	4	tel (2)
25	Aftësim teknologjik 6	60	18.2x25.7	1	4	tel (2)
26	Edukim figurativ 6	60	18.2x25.7	4	4	tel (2)
27	Historia 7	150	18.2x25.7	4	4	ngjitje
28	Gjeografia 7	150	18.2x25.7	4	4	ngjitje
29	Biologji dhe edukim shëndetësor 7	150	18.2x25.7	4	4	ngjitje
30	Edukata shoqërore 7	70	18.2x25.7	2	4	tel (2)
31	Edukim figurativ 7	60	18.2x25.7	4	4	tel (2)
32	Edukim muzikor 7	80	18.2x25.7	1	4	tel (2)
33	Aftësim teknologjik 7	80	18.2x25.8	2	4	tel (2)
34	Historia 8	140	18.2x25.7	2	4	ngjitje
35	Gjeografia 8	140	18.2x25.7	4	4	ngjitje
36	Biologji dhe edukim shëndetësor 8	150	18.2x25.7	4	4	ngjitje
37	Edukata shoqërore 8	60	18.2x25.7	4	4	tel (2)
38	Edukim figurativ 8	80	18.2x25.7	4	4	tel (2)
39	Edukim muzikor 8	120	18.2x25.7	2	4	ngjitje
40	Biologji dhe edukim shëndetësor 9	150	18.2x25.7	4	4	ngjitje
41	Edukatë shoqërore 9	60	18.2x25.7	4	4	tel (2)
42	Edukim muzikor 9	120	18.2x25.7	2	4	ngjitje
<b>Tituj të pakicës maqedonase</b>						
1	Gjuha maqedonase 1	120	20.7x27.7	4	4	ngjitje
2	Gjuha maqedonase 2	210	20.7x27.7	4	4	ngjitje
3	Gjuha maqedonase 3	240	20.7x27.7	4	4	ngjitje
4	Gjuha maqedonase 4	240	20.7x27.7	4	4	ngjitje
5	Gjuha maqedonase 5	240	20.7x27.7	4	4	ngjitje
6	Gjuha maqedonase 6	240	18.2x25.7	4	4	ngjitje
7	Gjuha maqedonase 7	260	18.2x25.7	2	4	ngjitje
8	Gjuha maqedonase 8	260	18.2x25.7	2	4	ngjitje
9	Gjeografi amtare 8	70	18.2x25.7	4	4	tel (2)
10	Gjuhe maqedonase 9	240	18.2x25.7	2	4	ngjitje
11	Histori amtare 9	70	18.2x25.7	4	4	tel (2)
<b>Tituj përkthime të pakicës maqedonase</b>						
1	Matematika 1	120	20.7x27.7	4	4	ngjitje
2	Matematika 1 - fletë pune	80	20.7x27.7	4	4	tel (2)
3	Edukatë shoqërore 1	50	20.7x27.7	4	4	tel (2)

4	Matematika 2	120	20.7x27.7	4	4	ngjitje
5	Matematika 2 - fletë pune	80	20.7x27.7	4	4	tel (2)
6	Edukata shoqërore 2	50	20.7x27.7	4	4	tel (2)
7	Matematika 3	180	20.7x27.7	4	4	ngjitje
8	Matematika 3 - fletë pune	120	20.7x27.7	4	4	ngjitje
9	Dituri natyre 3	140	20.7x27.7	4	4	ngjitje
10	Edukatë shoqërore 3	60	20.7x27.7	4	4	tel (2)
11	Matematika 4	200	20.7x27.7	4	4	ngjitje
12	Matematika 4 - fletë pune	120	20.7x27.7	4	4	ngjitje
13	Dituri natyre 4	180	20.7x27.7	4	4	ngjitje
14	Edukata shoqërore 4	60	20.7x27.7	4	4	tel (2)
15	Edukim muzikor 4	60	20.7x27.7	2	4	tel (2)
16	Dituri natyre 5	140	20.7x27.7	4	4	ngjitje
17	Edukata shoqërore 5	60	20.7x27.7	4	4	tel (2)
18	Edukata muzikore 5	60	20.7x27.7	2	4	tel (2)
19	Aftësim teknologjik 5	60	20.7x27.7	1	4	tel (2)
20	Biologji dhe edukim shëndetësor 6	120	18.2x25.7	4	4	ngjitje
21	Historia 6	120	18.2x25.7	4	4	ngjitje
22	Gjeografia 6	120	18.2x25.7	4	4	ngjitje
23	Edukata shoqërore 6	60	18.2x25.7	2	4	tel (2)
24	Edukim muzikor 6	60	18.2x25.7	1	4	ngjitje
25	Aftësim teknologjik 6	60	18.2x25.7	1	4	tel (2)
26	Edukim figurativ 6	60	18.2x25.7	4	4	tel (2)
27	Historia 7	150	18.2x25.7	4	4	ngjitje
28	Gjeografia 7	150	18.2x25.7	4	4	ngjitje
29	Biologji dhe edukim shëndetësor 7	150	18.2x25.7	4	4	ngjitje
30	Edukata shoqërore 7	70	18.2x25.7	2	4	tel (2)
31	Edukim figurativ 7	60	18.2x25.7	4	4	tel (2)
32	Edukim muzikor 7	80	18.2x25.7	1	4	tel (2)
33	Aftësim teknologjik 7	80	18.2x25.8	2	4	tel (2)
35	Historia 8	140	18.2x25.7	2	4	ngjitje
36	Gjeografia 8	140	18.2x25.7	4	4	ngjitje
37	Biologji dhe edukim shëndetësor 8	150	18.2x25.7	4	4	ngjitje
38	Edukata shoqërore 8	60	18.2x25.7	4	4	tel (2)
39	Edukim figurativ 8	80	18.2x25.7	4	4	tel (2)
40	Edukim muzikor 8	120	18.2x25.7	2	4	ngjitje
42	Biologji dhe edukim shëndetësor 9	150	18.2x25.7	4	4	ngjitje
43	Edukatë shoqërore 9	60	18.2x25.7	4	4	tel (2)
44	Edukim muzikor 9	120	18.2x25.7	2	4	ngjitje
<b>Arsimi i mesëm profesional</b>						
<b>Dega hoteleri - turizëm</b>						
1	Agjenci turistike 4, 5	300	16.1x23.4	1	4	ngjitje
2	Kontabiliteti 3, 4, 5	370	16.1x23.4	1	4	ngjitje
<b>Dega konfeksione - stilim</b>						
1	Baza qepje 3, 4	280	18.2x25.7	1	4	ngjitje
2	Baza prerje 3, 4	280	18.2x25.7	1	4	ngjitje
3	Merceologji tekstili 4	110	16.1x23.4	1	4	ngjitje
4	Anatomi artistike 4	110	18.2x25.7	1	4	ngjitje
5	Teknikë vizatimi 4	110	18.2x25.7	1	4	ngjitje
6	Stilim veshje 4	110	18.2x25.7	1	4	ngjitje
<b>Dega përpunim druri</b>						
1	Prodhime gjysmë të gatshme 2, 3	300	18.2x25.7	1	4	ngjitje

2	Tharje druri 3, 4	275	18.2x25.7	1	4	ngjitje
3	Teknologjia e prodhimit të mobilieve 4, 5	260	18.2x25.7	1	4	ngjitje
4	Prodhime gjysmë të gatshme 4, 5	300	18.2x25.7	1	4	ngjitje
5	Teknologjia e prodhimeve artistike 3	90	18.2x25.7	1	4	ngjitje

**Lloji i letres së bllokut të librit:**

***Për të gjitha llojet e librave:***

tip SUPERSNOËBRIGHT 80 ISO, 80 gsm, v = 2,0 cm<sup>3</sup>/g Bluish colour (ref. 1.0)

(letër krem 80 ISO, 80 gsm, v = 2,0 cm<sup>3</sup>/g Bluish colour (ref. 1.0))

***ose***

tip SUPERSNOËBRIGHT 80 ISO, 80 gsm, v = 2,0 cm<sup>3</sup>/g Creamy colour (ref. 8.0)

(letër krem 80 ISO, 80 gsm, v = 2,0 cm<sup>3</sup>/g Creamy colour (ref. 8.0))

***ose***

lloj letre e katalogizuar ekuivalente me dy tipet e mësipërme

**Lloji i kartonçinës së kopertinës:**

***Për librat me lidhje me tel kaluar:***

SIMCOT 260 g/m<sup>2</sup>

***Për librat me ngjitje:***

SIMCOT 280 g/m<sup>2</sup>

**Sqarime për lidhjen:**

tel (2) = tel kaluar me 2 kapje

3. TEKSTE ME MË SHUMË SE DY ALTERNATIVA QË DO TË PËRDOREN NË VITIN  
MËSIMOR 2009-2010

Tabela 2

Nr	Cikli / Titulli	Botuesi
I	II	III
	<b>Arsimi bazë</b>	
	<b>Klasa e parë</b>	
1	Abetare	SHBLSH e RE
2	Abetare - fletore pune	SHBLSH e RE
3	Abetarja ime	SHBLSH e RE
4	Abetare - fletore pune	SHBLSH e RE
5	Abetare	Shkronjë pas shkronje
6	Abetare - fletore pune	Shkronjë pas shkronje
7	Matematika 1	SHBLSH e RE
8	Matematika 1 - fletë pune	SHBLSH e RE
9	Matematikë 1	Albass
10	Matematikë 1 – fletë pune	Albass
11	Matematikë 1	Albpaper
12	Matematikë 1-fletë pune	Albpaper
	<b>Klasa e dytë</b>	
1	Gjuhë amtare 2	Albass
2	Gjuhë amtare 2	Media Print
3	Gjuhë amtare 2	Pegi
4	Gjuhë amtare 2	Progres
5	Edukatë shoqërore 2	Print 2000
6	Edukatë shoqërore 2	Albass
7	Edukatë shoqërore 2	Media Print
	<b>Klasa e tretë</b>	
1	Gjuhë shqipe 3	Albass
2	Gjuhë shqipe 3	SHBLSH e RE
3	Gjuhë shqipe 3	Shkronjë pas shkronje
4	Edukatë shoqërore 3	Erik
5	Edukatë shoqërore 3	Plejad
6	Edukatë shoqërore 3	Albass
7	Dituri Natyre 3	Albass
8	Dituri Natyre 3	D&U
9	Dituri Natyre 3	SHBLSH e RE
10	Anglisht 3	Elve
11	Anglisht 3-Fletore pune	Elve
12	Anglisht 3	Pegi
13	Anglisht 3-Fletore pune	Pegi
14	Anglisht 3	Erik
15	Anglisht 3-Fletore pune	Erik
16	Anglisht 3	Media Print
17	Anglisht 3-Fletore pune	Media Print
18	Anglisht 3	Express Publishing
19	Anglisht 3-Fletore pune	Express Publishing
20	Anglisht 3	Macmillan
21	Anglisht 3-Fletore pune	Macmillan
	<b>Klasa e katërt</b>	
1	Gjuhë shqipe 4	Morava
2	Gjuhë shqipe 4	Albass

3	Gjuhë shqipe 4	Sejko Infoservice
4	Gjuhë shqipe 4	Grafon
5	Gjuhë shqipe 4	Pegi
6	Gjuhë shqipe 4	Shkronjë pas shkronje
7	Edukatë shoqërore 4	Albass
8	Edukatë shoqërore 4	Erik
9	Edukatë shoqërore 4	Plejad
10	Dituri natyre 4	Albass
11	Dituri natyre 4	Pegi
12	Dituri natyre 4	SHBLSH e RE
13	Dituri natyre 4	Media Print
14	Matematikë 4	Albass
15	Matematikë 4 - Fletë pune	Albass
16	Matematikë 4	Erik
17	Matematikë 4 - Fletë pune	Erik
18	Matematikë 4	Albpaper
19	Matematikë 4 - Fletë pune	Albpaper
20	Matematikë 4	Pegi
21	Matematikë 4 - Fletë pune	Pegi
22	Matematikë 4	Alb-tipografika
23	Matematikë 4 - Fletë pune	Alb-tipografika
24	Histori 4	Albass
25	Histori 4	Lilo
26	Histori 4	Ideart
27	Histori 4	Uegen
28	Histori 4	Pegi
29	Edukim muzikor 4	Albass
30	Edukim muzikor 4	Morava
31	Edukim muzikor 4	Media Print
32	Gjuhë angleze 4	Albpaper
33	Gjuhë angleze 4-Fletore pune	Albpaper
34	Gjuhë angleze 4	Media Print
35	Gjuhë angleze 4-Fletore pune	Media Print
36	Gjuhë angleze 4	Pegi
37	Gjuhë angleze 4-Fletore pune	Pegi
38	Gjuhë angleze 4	Expres Publishing
39	Gjuhë angleze 4-Fletore pune	Expres Publishing
40	Gjuhë angleze 4	Macmillan
41	Gjuhë angleze 4-Fletore pune	Macmillan
42	Gjuhë angleze 4	Elve
43	Gjuhë angleze 4-Fletore pune	Elve
44	Gjuhë angleze 4	Erik
45	Gjuhë angleze 4-Fletore pune	Erik
	<b>Klasa e pestë</b>	
1	Gjuhë shqipe 5	Albass
2	Gjuhë shqipe 5	Albpaper
3	Gjuhë shqipe 5	Pegi
4	Gjuhë shqipe 5	Shkronjë pas shkronje
5	Dituri Natyre 5	Albass
6	Dituri Natyre 5	Media Print
7	Dituri Natyre 5	Pegi
8	Dituri Natyre 5	D&U
9	Dituri Natyre 5	Erik

10	Matematikë 5	Albass
11	Matematikë 5-Fletë pune	Albass
12	Matematikë 5	Albpaper
13	Matematikë 5-Fletë pune	Albpaper
14	Matematikë 5	D&U
15	Matematikë 5-Fletë pune	D&U
16	Matematikë 5	Ëeso
17	Matematikë 5-Fletë pune	Ëeso
18	Gjuhë angleze 5	Expres Publishing
19	Gjuhë angleze 5-Fletore pune	Expres Publishing
20	Gjuhë angleze 5	Macmillan
21	Gjuhë angleze 5-Fletore pune	Macmillan
22	Gjuhë angleze 5	Toena
23	Gjuhë angleze 5-Fletore pune	Toena
24	Gjuhë angleze 5	Arbëria 07
25	Gjuhë angleze 5-Fletore pune	Arbëria 07
26	Gjuhë angleze 5	Media Print
27	Gjuhë angleze 5-Fletore pune	Media Print
28	Gjuhë angleze 5	Erik
29	Gjuhë angleze 5-Fletore pune	Erik
30	Gjuhë angleze 5	Morava
31	Gjuhë angleze 5-Fletore pune	Morava
	<b>Cikli i lartë</b>	
	<b>Klasa e gjashtë</b>	
1	Matematikë 6	Albass
2	Matematika 6	Albpaper
3	Matematikë 6	Pegi
4	Matematikë 6	Myzemilli
5	Matematikë 6	Ëeso
6	Fizika 6	Erik
7	Fizika 6 - Fletore laborator	Erik
8	Fizika 6	Albass
9	Fizikë 6 - Fletore laborator	Albass
10	Fizikë 6	Uegen
11	Fizikë 6 - Fletore laborator	Uegen
12	Histori 6	Albass
13	Histori 6	Plejad
14	Histori 6	Ideart
15	Histori 6	Uegen
16	Histori 6	Morava
17	Edukatë shoqërore 6	Print 2000
18	Edukatë shoqërore 6	Albass
19	Edukatë shoqërore 6	Arbëria 07
20	Gjuhë angleze 6	Arbëria 07
21	Gjuhë angleze 6-Fletore pune	Arbëria 07
22	Gjuhë angleze 6	Erik
23	Gjuhë angleze 6-Fletore pune	Erik
24	Gjuhë angleze 6	Expres Publishing
25	Gjuhë angleze 6-Fletore pune	Expres Publishing
26	Gjuhë angleze 6	Macmillan
27	Gjuhë angleze 6-Fletore pune	Macmillan
	<b>Klasa e shtatë</b>	
1	Matematikë 7	Albpaper

2	Matematikë 7	D&U
3	Matematikë 7	SHBLSH e RE
4	Matematikë 7	Albass
5	Matematikë 7	Ëeso
6	Fizikë 7	Erik
7	Fizikë 7 - Fletore laborator	Erik
8	Fizikë 7	Dita 2000
9	Fizikë 7 - Fletore laborator	Dita 2000
10	Fizikë 7	SHBLSH e RE
11	Fizikë 7 - Fletore laborator	SHBLSH e RE
12	Fizikë 7	Uegen
13	Fizikë 7 - Fletore laborator	Uegen
14	Kimi 7	Uegen
15	Kimi 7	Dita 2000
16	Kimi 7	Albass
17	Kimi 7	Extra
18	Kimi 7	Alb-tipografika
19	Biologji dhe edukim shëndetësor 7	Albass
20	Biologji dhe edukim shëndetësor 7	Media print
21	Biologji dhe edukim shëndetësor 7	SHBLSH e RE
22	Histori 7	Albass
23	Histori 7	Dita 2000
24	Histori 7	Ideart
25	Gjeografi 7	Ideart
26	Gjeografi 7	Uegen
27	Gjeografi 7	Albpaper
28	Gjuhë angleze 7	Arbëria 07
29	Gjuhë angleze 7-Fletore pune	Arbëria 07
30	Gjuhë angleze 7	Erik
31	Gjuhë angleze 7-Fletore pune	Erik
32	Gjuhë angleze 7	Expres Publishing
33	Gjuhë angleze 7-Fletore pune	Expres Publishing
34	Gjuhë angleze 7	Macmillan
35	Gjuhë angleze 7-Fletore pune	Macmillan
	<b>Klasa e tetë</b>	
1	Matematikë 8	Albass
2	Matematikë 8	Lilo
3	Matematikë 8	Erik
4	Matematikë 8	Pegi
5	Matematikë 8	D&U
6	Matematikë 8	Progres
7	Biologji dhe edukim shëndetësor 8	Albass
8	Biologji dhe edukim shëndetësor 8	Media Print
9	Biologji dhe edukim shëndetësor 8	Uegen
10	Biologji dhe edukim shëndetësor 8	Erik
11	Biologji dhe edukim shëndetësor 8	Pegi
12	Fizikë 8	Albass
13	Fizikë 8 - Fletore laborator	Albass
14	Fizikë 8	Erik
15	Fizikë 8 - Fletore laborator	Erik
16	Fizikë 8	Uegen
17	Fizikë 8 - Fletore laborator	Uegen
18	Fizikë 8	Alb-tipografika

19	Fizikë 8 - Fletore laborator	Alb-tipografika
20	Kimi 8	Erik
21	Kimi 8	Dita 2000
22	Kimi 8	Extra- R
23	Kimi 8	Uegen
24	Kimi 8	SHBLSH e RE
25	Kimi 8	Albass
26	Kimi 8	Pegi
27	Edukim figurativ 8	Albass
28	Edukim figurativ 8	Erik
29	Edukim figurativ 8	Pegi
30	Histori 8	Dita 2000
31	Histori 8	Morava
32	Histori 8	Albass
33	Histori 8	Uegen
34	Histori 8	Pegi
35	Gjeografi 8	Ideart
36	Gjeografi 8	Uegen
37	Gjeografi 8	Pegi
38	Gjuhë angleze 8	Media Print
39	Gjuhë angleze 8-Fletore pune	Media Print
40	Gjuhë angleze 8	Arbëria 07
41	Gjuhë angleze 8-Fletore pune	Arbëria 07
42	Gjuhë angleze 8	Express Publishing
43	Gjuhë angleze 8-Fletore pune	Express Publishing
44	Gjuhë angleze 8	Macmillan
45	Gjuhë angleze 8-Fletore pune	Macmillan
46	Gjuhë angleze 8	Erik
47	Gjuhë angleze 8-Fletore pune	Erik
	<b>Klasa e nëntë</b>	
1	Matematikë 9	Albass
2	Matematikë 9	Pegi
3	Matematikë 9	Myzemilli
4	Matematikë 9	Erik
5	Matematikë 9	Lilo
7	Edukatë shoqërore 9	Albass
8	Edukatë shoqërore 9	Arbëria 07
9	Edukatë shoqërore 9	Lilo
10	Biologji dhe edukim shëndetësor 9	Albass
11	Biologji dhe edukim shëndetësor 9	Morava
12	Biologji dhe edukim shëndetësor 9	D&U
13	Fizikë 9	Albass
14	Fizikë 9 - Fletore laborator	Albass
15	Fizikë 9	Uegen
16	Fizikë 9 - Fletore laborator	Uegen
17	Fizikë 9	Erik
18	Fizikë 9 - Fletore laborator	Erik
19	Kimi 9	Albass
20	Kimi 9	Pegi
21	Kimi 9	Extra
22	Gjeografi 9	Ideart
23	Gjeografi 9	Uegen
24	Gjeografi 9	Pegi

25	Gjeografi 9	Arbëria 07
26	Gjuhë angleze 9	Express Publishing
27	Gjuhë angleze 9-Fletore pune	Express Publishing
28	Gjuhë angleze 9	Macmillian
29	Gjuhë angleze 9-Fletore pune	Macmillian
30	Gjuhë angleze 9	Arbëria 07
31	Gjuhë angleze 9-Fletore pune	Arbëria 07
32	Gjuhë angleze 9	Media Print
33	Gjuhë angleze 9-Fletore pune	Media Print
34	Gjuhë angleze 9	Pegi
35	Gjuhë angleze 9-Fletore pune	Pegi
36	Gjuhë angleze 9	Erik
37	Gjuhë angleze 9-Fletore pune	Erik
38	Gjuhë frënge 9	Media Print
39	Gjuhë frënge 9-Fletore pune	Media Print
40	Gjuhë frënge 9	Pegi
41	Gjuhë frënge 9-Fletore pune	Pegi
42	Gjuhë frënge 9	Elve
43	Gjuhë frënge 9-Fletore pune	Elve
<b>Arsimi i mesëm i përgjithshëm (Gjimnazi)</b>		
<b>Viti i tretë</b>		
1	Gjuhë angleze 11	Media Print
2	Gjuhë angleze 11-Fletore pune	Media Print
3	Gjuhë angleze 11	Express Publishing
4	Gjuhë angleze 11-Fletore pune	Express Publishing
5	Gjuhë angleze 11	Macmillian
6	Gjuhë angleze 11-Fletore pune	Macmillian
<b>Viti i katërt</b>		
1	Gjuhë angleze 12	Media Print
2	Gjuhë angleze 12-Fletore pune	Media Print
3	Gjuhë angleze 12	Elve
4	Gjuhë angleze 12-Fletore pune	Elve
5	Gjuhë angleze 12	Express Publishing
6	Gjuhë angleze 12-Fletore pune	Express Publishing

#### 4. UDHËZIME TË PËRGJITHSHME PËR PËRDORIMIN E TEKSTEVE NË SHKOLLAT E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

1. Hartimi dhe miratimi i standardeve lëndore të përmbajtjes, i planeve dhe programeve mësimore kryhet nga MASH, që i porosit ato pranë Institutit të Kurrikulave dhe Standardeve, në përputhje me politikat e zhvillimit të arsimit në vend.

2. Të gjitha shtëpitë botuese që kanë tekste të miratuara në përdorim do të lidhin kontratë për botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve me MASH, për vitin shkollor 2009-2010, pasi të kenë bërë korrigjimet përkatëse, sipas afateve të përcaktuara në “Kërkesën për tekste shkollore”.

3. Miratimi i teksteve shkollore

a) Miratimi i teksteve bëhet nga Komisioni i Miratimit të Teksteve Shkollore (KMT), pranë MASH, i cili shpall kërkesën për tekste shkollore, standardet e miratimit të tyre si dhe kryen krejt procesin e miratimit. Ai vepron sipas rregullores së miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Vendimet e KMT mund të apelojnë në rrugë administrative dhe më pas në rrugë gjyqësore. KMT mund të përjashtojë nga pjesëmarrja në proces shtëpitë botuese të përcaktuara në pikën 3 të “Kërkesës për tekste shkollore”.

b) KMT vendos për miratimin ose mosmiratimin e tekstit, duke u mbështetur në plotësimin e standardeve në tri aspekte: të përmbajtjes, të cilësive fizike të tekstit dhe të çmimit.

c) KMT ngre Komisionet e Shqyrtimit të Teksteve (KSHT) sipas lëndëve apo grup lëndëve. Këto komisione shqyrtojnë çdo tekst të paraqitur nga botuesit, nëse ai është në përputhje me standardet e përmbajtjes të shpallura nga KMT. Vlerësimet e tyre i shërbejnë KMT si mbështetje për vendimin përfundimtar.

d) KMT miraton paketën e teksteve të lëndës të paraqitur nga shtëpia botuese, që nënkupton tekste bazë si dhe tekste për punë nga nxënësi (Fletë Pune ose Fletore Laboratori, etj.), kur këto janë shpallur në kërkesën e MASH. Nëse njëri prej teksteve të paketës nuk miratohet, atëherë krejt paketa nuk miratohet për përdorim në shkollë.

e) Shpallja e miratimit bëhet publikisht në prani të botuesve të përfshirë në proces. Botuesve u komunikohet fakti i miratimit. Sipas kërkesës së tyre me shkrim drejtuar KMT për t'u njohur me arsyet e refuzimit, atyre u jepen vërejtjet dhe sugjerimet e vlerësimeve, të bëra për tekstin e paraqitur, fakti i miratimit ose mosmiratimit në tërësi ose për secilën fazë të vlerësimit, pa specifikuar pikët e vlerësimit të përgjithshëm ose pikët e vlerësimit të përmbajtjes.

f) Kur teksti i miratuar është i shtypur dhe gati për përdorim, shtëpia botuese e paraqet atë në KMT dhe ky verifikon realizimin apo mosrealizimin e cilësive në të cilat është mbështetur miratimi i tij. Vetëm pas këtij verifikimi, shtëpia botuese merr Certifikatën e lejes nga KMT për shitjen e tekstit. Të gjitha këto rregullohen në kontratën ndërmjet botuesit dhe MASH për botimin, shpërndarjen dhe shitjen e tekstit, e cila nënshkruhet pasi teksti është miratuar. Tekste të certifikuar nga MASH nuk lejohet të shiten dhe as të përdoren në shkolla pa vendosur pullën e certifikimit.

g) Teksti i certifikuar mund të ribotohet dhe të hidhet në treg sa herë që shtëpitë botuese e quajnë të nevojshme dhe programi mësimor nuk ka ndryshuar. Në rast se shtëpitë botuese bëjnë ndryshime përmirësuese brenda tekstit, para rishtypjes, ato janë të detyruara të marrin miratimin e KMT. Në këtë rast KMT shprehet me shkrim, brenda dy javësh, pa kaluar në procedurën e përcaktuar më lart, në qoftë se ndryshimet nuk kalojnë 15 % të tekstit dhe nuk prekin titullin e tekstit, tematikën, standardet dhe objektivat e programit mësimor. Kur ndryshimet janë më tepër se 15 %, KMT aktivizon Komisionin e Shqyrtimit të Tekstit përkatës, vlerësimet e të cilit i shërbejnë KMT për të marrë vendim.

#### 4. Shtëpitë Botuese

a) Çdo shtëpi botuese ka të drejtë të marrë pjesë në konkurrimin për tekste shkollore, nëse e ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi, nuk ka çështje të hapura me organet gjyqësore ose me prokurorinë dhe nuk është në proces falimentimi. Përrjashtohen nga kjo e drejtë shtëpitë botuese të cilat përmenden në paragrafin 3, pika a si dhe ato që nuk kryejnë korrigjimet e teksteve sipas pikës II, 1, b të "Kërkesës për tekste shkollore".

#### b) Rregulli i konfliktit të interesit

Punonjësi i MASH, IKT, i DAR/ZA nuk mund të jetë njëherësh edhe autor teksti ose i lidhur me një shtëpi botuese pjesëmarrëse në sistemin konkurrues të tregut të teksteve shkollore. Në rastin kur drejtori dhe zëvendësdrejtori i një shkolle është autor teksti ose ka lidhje interesi të drejtpërdrejta ose të tërthorta me një shtëpi botuese, në shkollën e tij ndalohet përdorimi i atij teksti dhe i teksteve të asaj shtëpie botuese.

Punonjësi si më sipër, i nënshtrohet automatikisht rregullit të shmangies së konfliktit të interesit, menjëherë, nëse teksti i tij paraqitet për herë të parë, ose që nga çasti kur teksti i tij, i cili ka qenë në përdorim, nuk është më i vetëm në tregun e përzgjedhjes nga shkollat, d.m.th, kur ka tekst alternativ konkurrent. Në këto raste:

- Teksti i paraqitur me autor një punonjës si më sipër nuk miratohet. Nëse për shkak të paraqitjes së një dëshmie të rreme nga botuesi, miratimi ndodh dhe teksti ka dalë në qarkullim, atëherë MASH ka të drejtë të zgjidhë konfliktin e interesit, duke marrë masën e shkarkimit të autorit nga detyra që shkakton gjendjen në konflikt. Njëkohësisht, botuesi përjashtohet nga e drejta për të paraqitur tekste për miratim pranë MASH për pesë vitet në vijim.

- Kur teksti ka qenë në përdorim dhe rishtas miratohet një tekst tjetër alternativ i tij, konflikti zgjidhet me zgjedhjen e autorit midis largimit të tij nga vendi i punës që shkakton gjendjen në konflikt, ose me ndalimin e përdorimit në shkollë të tekstit të tij.

Personat, të cilët janë autorë tekstesh apo kanë interesa të lidhura me shtëpitë botuese pjesëmarrëse në sistemin konkurrues të tregut të teksteve shkollore, nuk lejohet të marrin pjesë në KSHT për vlerësimin e teksteve. Në këto raste:

- Tekste të paraqitura për vlerësim nuk miratohen.

- Nëse për shkak të paraqitjes së një dëshmie të rreme nga vlerësuesi, miratimi ndodh dhe teksti

ka dalë në qarkullim, atëherë MASH ka të drejtë të përjashtojë këtë vlerësues nga sistemi arsimor dhe të ndalojë përdorimin në shkolla të këtyre teksteve. Njëkohësisht, botuesi përjashtohet nga e drejta për të paraqitur tekste për miratim pranë MASH për pesë vitet në vijim.

c) Kur teksti është miratuar nga KMT dhe Shtëpia Botuese largohet nga procesi, duke refuzuar nënshkrimin e kontratës me MASH, kjo Shtëpi Botuese përjashtohet nga e drejta për të paraqitur tekste për miratim pranë MASH për pesë vitet në vijim.

d) Shtëpia Botuese merr përsipër:

- Marrëdhëniet me autorët;
- Përgatitjen e origjinaleve për shtyp;
- Marrjen e porosive për tekste nga shkollat;
- Shtypjen;

- Shitjen e teksteve pranë librarive dhe zyrave postare pranë shkollave porositëse, përkundrejt faturave individuale të shitjes, lëshuar për secilin nxënës.

Në rast nevojë shkolla vë në dispozicion të shitjes mjediset e veta, por personelit edukativ i ndalohet pjesëmarrja në procesin e shitblerjes.

e) Shtëpia botuese ka të drejtë të dërgojë për përzgjedhje kopje të tekstit të saj të certifikuar në çdo shkollë të Republikës së Shqipërisë. Në rastin e një teksti të ribotuar me korrigjime, botuesi mund të çojë në shkolla tekst të ribotuar ose material informues mbi ndryshimet e bëra në tekstin e ribotuar.

Shtëpia botuese është e detyruar të çojë një kopje të çdo titulli të ri teksti në të gjitha shkollat që e përdorin atë tekst. Në këtë rast, kopjet e këtyre teksteve blihen nga DAR/ZA-të dhe bëhen pronë e bibliotekës së shkollës përkatëse.

Në kopertinën e çdo kopjeje të tekstit, shënohet çmimi, barkodi dhe vendoset pulla me hologramë e certifikimit nga MASH, përpara nxjerrjes së tij në shitje.

#### 5. Përzgjedhja e teksteve shkollore

a) Drejtori i shkollës organizon procesin e përzgjedhjes së teksteve, sipas procedurave të caktuara nga MASH.

b) Përzgjedhja e teksteve që do të përdoren nga shkolla bëhet nga Komisionet e Përzgjedhjes së Teksteve (KOPT). KOPT-et veprojnë në bazë shkolle, sipas lëndëve apo grup-lëndëve dhe përbëhen nga të gjithë mësuesit e së njëjtës lëndë ose të një grup-lënde të asaj shkolle. Kur numri i mësuesve të një KOPT është më i vogël se pesë, DAR/ZA autorizon krijimin e KOPT-eve mbi bazën e dy shkollave. Në këtë rast, raportues është drejtori i shkollës më të madhe. DAR/ZA-t çojnë në KMT listën e KOPT-eve dhe të mësuesve anëtarë të tyre.

c) KOPT-et e marrin listën e teksteve të certifikuara nga KMT dhe bëjnë përzgjedhjen brenda afateve të përcaktuara për vitin e ardhshëm shkollor.

d) Drejtori i shkollës njofton me shkresë zyrtare MASH e DAR/ZA përkatëse për llojet dhe sasinë e teksteve të përzgjedhura nga shkolla/shkollat, si dhe bën porosinë në shtëpitë botuese përkatëse, duke u dërguar atyre shkresë me postë të sigurt.

#### 6. Porosia dhe shitblerja e teksteve

a) Drejtori i shkollës porosinë për nxënësit furnizimin me sasinë e kërkuar të teksteve të botuesit, duke dërguar shkresën me postë të sigurt në datat 28 Maj - 4 Qershor 2009, sipas Grafikut të zbatimit të sistemit të sigurimit të teksteve, për vitin shkollor 2009-2010, në pikat 8.1, 8.2, 8.3 të këtij Udhëzuesi.

Një kopje e shkresës i çohet njëkohësisht KMT.

b) Drejtori i shkollës përpilon në tri kopje listën e kompensimit në favor të prindërve, sipas modelit të caktuar nga MASH dhe dërgon dy prej tyre në DAR/ZA përkatëse; kjo e fundit dërgon menjëherë një kopje në Drejtorinë e Planifikimit Buxhetor, në MASH.

c) MASH u kalon DAR/ZA-ve kompensimin që u takon dhe këto e shpërndajnë atë tek prindërit, përmes postës apo bankave, sipas listave të drejtorëve të shkollave.

d) Titujt e rinj të teksteve që shtëpitë botuese dërgojnë në shkolla për t'ua paraqitur KOPT-ve, u paguhen botuesve me urdhër-pagese të veçantë nga shkolla, kur kjo ka llogari buxhetore të vetën, ose nga DAR/ZA përkatëse në rastet e tjera. Drejtorja e Planifikimit Buxhetor në MASH ndjek likuidimin në kohë të detyrimeve ndaj botuesve.

7. Publikimi i Paketës Informuese të ALTERTEKST 2009 dhe shpërndarja e programeve mësimore botueseve do të bëhen brenda muajit shkurt 2009. Grafiku i furnizimit të shkollave me tekste për vitin shkollor 2009 - 2010 do të jetë si më poshtë:

7.1. Për tekstet me një, dy, tre dhe më shumë alternativa, për të cilat nuk ka vërejtje:

- Lidhja e kontratave fillon nga 11 prill 2009
- Përzgjedhja e teksteve në shkolla 20 – 27 maj 2009
- Porosia e teksteve nga shkollat 28 maj – 4 qershor 2009
- Shpërndarja 15 korrik – 15 gusht 2009

7.2. Për tekstet me një, dy, tre dhe më shumë alternativa, për të cilat ka vërejtje:

- Marrja e vërejtjeve në KMT nga botuesit 2– 5 mars 2009
- Dorëzimi i teksteve të korrigjuara pranë KMT deri në 26 mars 2009
- Vlerësimi dhe miratimi i teksteve të korrigjuara deri në 10 prill 2009
- Lidhja e kontratave fillon nga data 30 prill 2009
- Përzgjedhja e teksteve në shkolla 20 – 27 maj 2009
- Porosia e teksteve nga shkollat 28 maj – 4 qershor 2009
- Shpërndarja 15 korrik – 15 gusht 2009

7.3. Për titujt e teksteve të pabotuara deri tani, për alternativat e reja të teksteve ekzistuese me një dhe dy alternativa, për tekstet e pakicave kombëtare dhe arsimit profesional:

- Dorëzimi i teksteve 20 - 27 prill 2009
- Vlerësimi dhe miratimi i teksteve 28 prill – 10 maj 2009
- Lidhja e kontratave fillon nga data 11 maj 2009
- Përzgjedhja në shkolla 20-27 maj 2009
- Porosia e teksteve nga shkollat 28 maj – 4 qershor 2009
- Shpërndarja 15 korrik – 15 gusht 2009

Shënim:

a) Pas miratimit, botuesit do t'i sjellin tekstet për certifikim deri në datën 15 maj 2009, duke i paraprirë procesit të përzgjedhjes nga shkollat.

b) MASH mirëpret çdo realizim përpara afateve të dhëna më lart nga të gjithë aktorët e procesit.

#### 5. DOKUMENTET QË BOTUESI DORËZON PËR MIRATIM TEKSTI

Botuesi që aplikon për miratim teksti, dorëzon në KMT, në MASH, dokumente kualifikimi dhe ofertat përkatëse, si më poshtë. Të gjitha dokumentet e kualifikimit dhe ato të tekstit duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer në shqip dhe të noterizuara.

Dokumentet dhe materialet që dorëzohen

Dokumente kualifikimi

1. Vendimi i gjykatës për regjistrimin si person juridik me të drejtë ushtrimi aktiviteti si Shtëpia Botuese.

2. Certifikatë e regjistrimit në organet tatimore për ushtrimin e veprimtarisë në biznesin e botimit.

3. Vërtetim nga gjykata që Shtëpia Botuese dhe administratori që aplikon në emër të saj nuk janë në proces gjyqësor në lidhje me aktivitetin.

4. Vërtetim nga Prokuroria e Rrethit që Shtëpia Botuese dhe administratori që aplikon në emër të saj nuk janë në ndjekje penale.

5. Vërtetim nga drejtorja e tatimeve dhe e taksave për shlyerjen e detyrimeve përkatëse.

6. Vërtetim nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit që Botuesi nuk ka detyrime financiare karshi të tretëve dhe që Shtëpia Botuese që përfaqëson nuk është në proces falimentimi.

Shënim:

Dokumentet e pikave 1 – 6 duhet të jenë jo më të vjetra se tre muaj nga data e dorëzimit pranë MASH.

Dokumente të tekstit

1. Kopje e noterizuar e kontratës ndërmjet shtëpisë botuese dhe autorit/autorëve e vitit 2009.

2. Lista emërore e autorëve të tekstit sipas pjesëve përkatëse të autorësisë (modeli bashkëngjitur).

3. Deklarata e botuesit dhe e autorëve që nuk janë në gjendje të konfliktit të interesit për të qenë respektivisht pjesëmarrës në tregun konkurrues të teksteve dhe autorë të tekstit, përkundërt punësimit të tyre në administratën shtetërore të arsimit të parashikuar në këtë Paketë Informuese (modeli bashkëngjitur).

4. Deklarata e të drejtave të autorësisë (kopirajtit) mbi origjinalitetin e veprës në tërësi dhe pjesëve të saj si dhe kopje të akteve ose marrëveshjeve që mund të jenë bërë për lejen ose blerjen e elementeve të veçanta të kopirajtit nga të tretë (modeli bashkëngjitur).

5. Deklarata për specifikimet teknike të tekstit që dëshmon respektimin e specifikimeve minimale të vëna, si dhe formatin e zgjedhur të tekstit (modeli bashkëngjitur).

6. Deklarata për çmimin e shitjes së tekstit (modeli bashkëngjitur).

Shënim:

Dokumentet e pikave 1-3 duhet të jenë jo më të vjetra se tre muaj nga data e dorëzimit pranë MASH.

Materiali i tekstit për miratim

7. Pesë kopje të tekstit që paraqitet për miratim, secila me 100% të materialit të tekstit, tërësisht i redaktuar nga ana shkencore, metodike dhe gjuhësore, i faqosur me gjithë figurat, ilustrimet, skicat, hartat e ngjyrat (nëse parashikohen) etj., i shtypur dhe i prerë në trajtë përfundimtare në llojin e letrës dhe formatin e përzgjedhur sipas specifikimeve teknike, ashtu sikundër do të dalë nga shtypshkronja.

8. Çdo kopje e tekstit të paraqitur të jetë e lidhur në trajtë provizore me vrima e me kapëse plastike.

Shënim:

1. Asnjë prej kopjeve të tekstit që paraqitet për miratim nuk duhet të jetë e lidhur në trajtë përfundimtare dhe as duhet të përmbajë shenjat e zakonshme të identifikimit (kopertinën, autorët, emrin apo logon e shtëpisë botuese etj.), sikundër do të ishte në gjendjen e gatshme për shitje, si dhe asnjë shenjë tjetër që do të mundësonte identifikimin e shtëpisë botuese apo autorëve. Titulli i tekstit në kopjet e dorëzuara duhet të vendoset sipas emërimit në listën e kërkuar dhe të shpallur nga MASH dhe jo i stilizuar sipas karakterit të linjës që ka ndjekur shtëpia botuese apo autorët e tekstit; titulli i stilizuar mund të rivendoset pas miratimit të mundshëm.

2. Për tekstet e përkthyer të shkollave të pakicave kombëtare paraqiten vetëm dy kopje.

Mënyra e paraqitjes së dokumenteve dhe materialeve

1. Dokumentet e kualifikimit vendosen sipas radhës 1 - 6 në një zarf të bardhë me format A4, që dorëzohet i mbyllur.

2. Dokumentet e tekstit

- Zarfi i dyllosur. Në një zarf të bardhë me format A4, që dorëzohet i mbyllur e i dyllosur nga botuesi, vendosen sipas radhës të gjitha "Dokumentet e tekstit" nga pika 1 deri 6. Zarfi duhet të jetë pa shenja të jashtme dalluese, që do të mund të zbulonin përkatësinë e tij. Dokumentet e këtij zarfi janë të gjitha të firmosura e, sipas rastit, të vulosura.

- Zarfi i pa dyllosur. Krahas zarfit të dyllosur me dokumentet e tekstit, dorëzohet dhe një zarf i pa dyllosur, i bardhë me format A4, me kopje të dokumenteve të tekstit që tregohen në pikat 5 dhe 6 "Dokumentet e tekstit". Në këtë rast, këto dokumente nuk do të përmbajnë firma, apo vula si dhe çfarëdo shenje tjetër që do të mund të lejonin identifikimin e origjinës së tyre (si p.sh, logo, emra, vula apo firma e botuesit ose autorëve etj.). Në rast të kundërt, teksti përjashtohet nga procesi i aplikimit dhe i vlerësimit.

- Çdo tekst që paraqitet për miratim ka zarfin e vet të dyllosur dhe atë të pa dyllosur.

3. Materiali i tekstit për miratim

- Kopjet e tekstit për miratim paktohen në letër të bardhë, secila më vete. Mbi secilën prej tyre botuesi shënon titullin e tekstit (jo të stilizuar) dhe numrin e pakos 1 - 5. Të gjitha paketat e të njëjtit tekst dorëzohen të paketuara në kuti kartoni të veçantë ose të mbështjella me letër ambalazhi, që i ruan nga dëmtimi.

- Zarfi i dyllosur dhe zarfi i pa dyllosur vendosen brenda kutisë së kartonit ose ambalazhimit të tekstit përkatës.

- Kopjet e tekstit si dhe materialet e paketimit duhet të jenë pa shenja ose tregues që do mund të lejonin identifikimin e autorit ose botuesit. Në raste kur verifikohen të tilla, teksti përkatës përjashtohet nga procesi i aplikimit dhe i vlerësimit.

Pranimi dhe ruajtja e fshehtësisë së dokumenteve dhe materialeve

1. Zarfi me dokumentet e kualifikimit hapet nga marrësi në dorëzim, përfaqësues i KMT, në çastin e dorëzimit dhe në prani të dorëzuesit përfaqësues të botuesit. Përmbajtja e tij shqyrtohet në çast dhe nëse gjendet gjithçka në rregull, dokumentet ruhen nga marrësi në dorëzim dhe vazhdohet me marrjen në dorëzim të dokumenteve dhe materialeve të tjera. Në të kundërt, aplikimi i botuesit nuk pranohet.

2. Në çastin kur e gjithë paketa merret në dorëzim, marrësi në dorëzim heton për shenja të jashtme të mundshme në paketat. Nëse nuk gjen të tilla, vendos mbi secilën kopje të tekstit të dorëzuar si

dhe në të dy zarfet e dokumenteve të teksteve të njëjtin kod që jep përkatësinë e zarfeve me kopjet e teksteve.

3. Zarfi i dyllosur veçohet në kasafortë. Zarfi i pa dyllosur mbahet edhe ai i veçuar dhe hapet vetëm nga KMT, mbasi janë caktuar vlerësimet me pikë për përmbajtjen e tekstit dhe teksti ka kaluar me sukses fazën e parë të miratimit, atë të përmbajtjes.

4. Zarfi i dyllosur që mbahet në kasafortë hapet në çastin e shpalljes së përfundimeve të vlerësimit të teksteve, para të gjithë botuesve pjesëmarrës të pranishëm. Pasi të jenë shpallur më parë rezultatet e miratimit sipas kodeve, hapen zarfet e dyllosura në prani të të gjithë botuesve dhe zbulohet përkatësia e tekstit të miratuar me botuesin, sipas kodeve të vendosura në zarfe dhe në pakot e tekstit. Botuesi që del t'i përkasin të dhënat e zarfit i dorëzon aty për aty komisionit kopjen e vet të tekstit për të verifikuar edhe një herë njëjtësinë me kopjet që i përkasin atij zarfi, pra nëse është njëjloj me ato që janë dorëzuar në datën e pranimit. Për këtë qëllim, botuesi duhet të ketë një kopje identike të tekstit, për të vërtetuar përkatësinë dhe këtë duhet ta sjellë me vete ditën e shpalljes së teksteve të miratuara. Më tej, shqyrtimi i posaçëm i dokumenteve që përmban zarfi i dyllosur përfundon me konfirmimin ose jo të miratimit të tekstit përkatës.

5. Dorëzimi i teksteve nga botuesit bëhet në afatin e shpallur në Buletinin e Njoftimeve Publike nga secili botues veç e veç, sipas radhës së paraqitjes. Aplikimet që paraqiten kur afati ka kaluar, nuk pranohen.

## 6. KRITERET E VLERËSIMIT TË PËRMBAJTJES

Nr	Zëri	Pikët e vlerësimit minimal	Pikët e vlerësimit maksimal
1	<b>Përputhja me tematikën e programit të lëndës</b>	6	6
2	<b>Përmbajtja</b>	16	20
	(a) A ka saktësi shkencore?	10	12
	(b) A janë bashkëkohore modelet shkencore-didaktike?	6	8
3	<b>Gjuha</b>	9	13
	(a) A është shkruar saktë nga pikëpamja gjuhësore?	2	3
	(b) A është e pastër gjuha e përdorur?	2	3
	(c) A është gjuha e përdorur në përshtatje me moshën?	5	7
4	<b>Metodologjia</b>	15	25
	(a) A është në përshtatje me moshën shkalla e vështirësisë?		
	(b) A është në përshtatje me moshën sasia e njohurive?		
	(c) A është tërheqës për moshën?		
	(d) A aftësohen nxënësit për të nxënëit individual dhe në grup?		
(e) A nxitet të menduarit logjik, zbulues, kritik, krijues?			
5	<b>Paraqitja, disenjimi</b>	7	13
	(a) Faqosja		
	(b) Lexueshmëria për moshën dhe Përshtatshmëria ndaj përmbajtjes. (c) Pamja tërheqëse, Cilësia, Stili		
6	<b>Ndjeshmëria ndaj barazisë</b>	6	8
	(a) Të mos shfaqë dallime për shkak të gjinisë	1	2
	(b) Të mos shfaqë dallime për shkak të racës apo kombësisë	2	2
	(c) Të mos shfaqë dallime për shkak të fesë	2	2
	(d) Të mos shfaqë dallime për shkak të qenies në pakicë.	1	2
7	<b>Përmbushja e objektivave të programit të lëndës</b>	11	15
<b>VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM</b>		<b>70</b>	<b>100</b>

Kalimi i fazës së parë të miratimit të tekstit

1. Nëse teksti vlerësohet me jo më pak se pikët minimale për secilin nga zërat dhe në tërësi ka grumbulluar jo më pak se 80 pikë, atëherë ky tekst kalon me sukses fazën e parë të miratimit.

2. Në rast se teksti vlerësohet me më pak se pikët minimale qoftë dhe në një prej zërave, apo nënzhërave atëherë teksti nuk kalon fazën e parë të miratimit dhe vlerësimi i tij i mëtejshëm në fazën e dytë për çmimin nuk vijon.

3. Nëse teksti vlerësohet me më pak se 80 pikë gjithsej, atëherë teksti nuk e kalon fazën e parë të miratimit dhe vlerësimi i tij i mëtejshëm në fazën e dytë për çmimin nuk vijon, pavarësisht nëse mund të jetë vlerësuar me jo më pak se pikët minimale në secilin prej zërave.

#### 7. VLERËSIMI I ÇMIMIT, VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM DHE MIRATIMI

I. Formula e pikëve për vlerësimin e çmimit

$$p = 55 \cdot \frac{B}{\zeta + b}$$

Formula e pikëve të çmimit është

ku: B dhe b kanë vlera të dhëna në tabelën e koeficienteve për çdo tekst më vete.

$\zeta$  është çmimi në lek që zgjedh botuesi,

p është numri i pikëve që përftohen për çmimin e zgjedhur nga botuesi.

P.sh., për tekstin “Dituri Natyre” të klasës së katërt, në tabelën e koeficienteve janë dhënë  $B = 330$  dhe  $b = 30$ . Formula e pikëve për këtë tekst është:

$$p = 55 \cdot \frac{330}{\zeta + 30}$$

Nëse botuesi zgjedh çmimin 260 lekë, atëherë në formulën e pikëve ky çmim vendoset në vend të  $\zeta$ -së dhe pikët që merr për këtë çmim janë:

$$p = 55 \cdot \frac{330}{\zeta + 30} = 55 \cdot \frac{330}{260 + 30} = 55 \cdot \frac{330}{290} = 62,6$$

Numri i pikëve rrumbullakoset deri në një shifër pas presjes dhjetore.

II. Formula e vlerësimit të përgjithshëm

Formula e pikëve të vlerësimit të përgjithshëm është:  $P = N + p$ ,

ku: N është numri i pikëve në vlerësimin e përmbajtjes së tekstit,

p është numri i pikëve në vlerësimin e çmimit nga formula më sipër.

P është numri i pikëve të vlerësimit të përgjithshëm të tekstit.

III. Kushtet dhe fazat e miratimit

Teksti miratohet kur plotëson të gjitha kushtet sipas radhës më poshtë:

- i. Teksti miratohet nga përmbajtja (faza e parë e miratimit).
- ii. Teksti grumbullon të paktën 145 pikë në vlerësimin e përgjithshëm (faza e dytë e miratimit).
- iii. Botuesi është deklaruar për respektimin e specifikimeve teknike të tekstit të shpallura si tregues minimalë në tabelën përkatëse (faza e tretë e miratimit).
- iv. Verifikimi përfundimtar i dokumenteve të tekstit në zarfën e dyllosur (faza e katërt e konfirmimit të miratimit).

1. Teksti që nuk kalon fazën e parë të miratimit nga përmbajtja, nuk kualifikohet për t'u shqyrtuar në fazat e mëtejshme dhe nuk miratohet.

2. Teksti që kalon fazën e parë të miratimit nga përmbajtja, por nuk kalon të dytën, nuk kualifikohet për t'u shqyrtuar në fazën e tretë dhe nuk miratohet. Me fjalë të tjera, teksti që në vlerësimin e përgjithshëm merr më pak se 145 pikë nuk miratohet, pavarësisht se është miratuar nga përmbajtja.

3. Teksti që kalon fazën e parë e të dytë të miratimit, por nuk kalon të tretën, nuk miratohet. Me fjalë të tjera, teksti për të cilin nuk është paraqitur deklarata për respektimin e të gjitha specifikimeve teknike të tij sipas tabelës përkatëse nuk miratohet, pavarësisht se është miratuar nga përmbajtja dhe pavarësisht që në vlerësimin e përgjithshëm ka arritur të marrë të paktën 145 pikë.

Nëse, p.sh., për një tekst të Diturisë së Natyrës për klasën e katërt:

i. vlerësimi i përmbajtjes është 85 pikë,

ii. botuesi ka zgjedhur çmimin 260 lekë (pra, vlerësimi për çmimin është 62,6 pikë dhe vlerësimi i përgjithshëm është  $P = 85 + 62,6 = 147,6$ ),

iii. botuesi deklarohet për respektimin e specifikimeve teknike të tekstit sipas tabelës përkatëse, atëherë vendimi është se ky tekst shpallet i miratuar me prezumim të konfirmimit të rregullsisë së dokumenteve të tekstit në zarfin e dyllosur.

4. Mbas shpalljes së miratimit me prezumim, shqyrtohen dokumentet e tekstit që ndodhen në zarfin e dyllosur tashmë të hapur pas shpalljes dhe verifikohet rregullsia dhe përputhshmëria e dokumenteve me kriteret e kësaj Pakete Informuese. Mbasi këtij verifikimi, merret vendimi përfundimtar që teksti miratohet ose nuk miratohet.

5. Vendimi i mosmiratimit ose i miratimit nuk mund të rishqyrtohet. Ndryshimi i çmimit, ose i kushteve të tjera të ofruara nga botuesi për tekstin e paraqitur për miratim, me qëllim ndryshimin e vendimit që është marrë për mosmiratimin ose miratimin e tekstit me qëllim përmirësimin në favor të botuesit të kushteve të paraqitura, nuk lejohet. Kështu,

a) Nuk lejohet të rishqyrtohet vendimi i mosmiratimit të tekstit:

- për një çmim më të ulët që botuesi mund të ofrojë me qëllim që të mbërrijë kufirin kritik prej 145 pikësh të vlerësimit të përgjithshëm, pavarësisht se teksti mund të ketë kaluar të fazën e parë të miratimit.

- për ndryshime të deklaratës së specifikimeve teknike, kur mosmiratimi ka si shkak mosplotësimin e standardeve të kërkuara të këtyre specifikimeve.

b) Nuk lejohet të rishqyrtohet vendimi i miratimit të tekstit, për një çmim më të lartë të ofruar nga botuesi për të cilin përsëri teksti mbërrin kufirin kritik prej 145 pikësh të vlerësimit të përgjithshëm, falë një vlerësimi të lartë që teksti mund të ketë marrë për nga përmbajtja.

#### IV. Raste të veçanta

1. Në rast të rikërkesës për tekste nga KMT, për të njëjtat specifikime teknike, programe dhe kritere vlerësimi, nëse paraqitet prej botuesit i njëjti varianti i mëparshëm pa asnjë ndryshim, teksti ka automatikisht të njëjtin vlerësim për përmbajtjen si edhe në rastin e mëparshëm të paraqitjes.

2. KMT miraton paketën e teksteve të lëndës të paraqitur nga shtëpia botuese, që nënkupton tekste bazë si dhe tekste për punë nga nxënësi (Fletë Pune ose Fletore Laboratori etj.), kur këto janë shpallur në kërkesën e MASH-it. Nëse njëri prej teksteve të paketës nuk miratohet, atëherë krejt paketa nuk miratohet për përdorim në shkollë.

3. Për teksteve të shkollave të pakicave kombëtare ndiqen të njëjtat kritere dhe procedura si më sipër. Në rastin kur ato janë përkthime të teksteve shqip, atëherë miratimi i tyre bëhet për kushtet shtesë të mëposhtme:

i. Teksti në shqip që përkthehet duhet të jetë paraprakisht i miratuar nga KMT.

ii. Vlerësimi bëhet sipas të njëjtës tabelë pikësh dhe me të njëjtat pikë që është vlerësuar teksti në shqip nga i cili bëhet përkthimi, me përjashtim të saktësisë dhe pastërtisë gjuhësore, që rivlerësohen në variantin e përkthyer, duke përdorur po ata kufij pikësh.

Në saktësinë gjuhësore të tekstit të përkthyer, vlerësohet edhe besnikëria e përkthimit nga varianti shqip i tekstit.

### 8. KOEFICIENTËT E FORMULËS SË VLERËSIMIT TË ÇMIMIT

Nr	Cikli / Titulli	B	b
<b>I</b>	<b>II</b>	<b>III</b>	<b>IV</b>
	<b>Arsimi bazë</b>		
	<b>Klasa e parë</b>		
1	Edukatë shoqërore	141	13
	<b>Klasa e dytë</b>		
1	Matematika	283	26
2	Matematika - fletë pune	198	18
	<b>Klasa e tretë</b>		
1	Matematika	372	34
2	Matematika - fletë pune	253	23
3	Gjuha frënge	520	47
4	Gjuha frënge - fletore pune	348	32
5	Gjuha italiane	520	47
6	Gjuha italiane - fletore pune	348	32


	<b>Klasa e katërt</b>		
1	Gjuha frënge	520	47
2	Gjuha frënge - fletore pune	348	32
3	Gjuha italiane	520	47
4	Gjuha italiane - fletore pune	348	32
	<b>Klasa e pestë</b>		
1	Edukata shoqërore	142	13
2	Edukim muzikor	142	13
3	Aftësim teknologjik	112	10
4	Gjuha frënge	520	47
5	Gjuha frënge - fletore pune	348	32
	<b>Klasa e gjashtë</b>		
1	Gjuha shqipe	475	43
2	Biologji dhe edukim shëndetësor	238	22
3	Gjeografia	238	22
4	Edukim muzikor	123	11
5	Aftësim teknologjik	123	11
6	Edukim figurativ	133	12
7	Gjuha frënge	416	38
8	Gjuha frënge - fletore pune	312	28
9	Gjuha angleze për fillestarë (kl. 6 dhe 7)	694	63
10	Gjuha angleze - fl. pune për fill. (kl. 6 dhe 7)	520	47
11	Gjuha frënge për fillestarë (kl. 6 dhe 7)	694	63
12	Gjuha frënge - fl. pune për fill. (kl. 6 dhe 7)	520	47
13	Gjuha italiane për fillestarë (kl. 6 dhe 7)	868	79
14	Gjuha italiane - fl. pune për fill. (kl. 6 dhe 7)	650	59
	<b>Klasa e shtatë</b>		
1	Gjuha shqipe	475	43
2	Edukata shoqërore	119	11
3	Edukim figurativ	133	12
4	Edukim muzikor	164	15
5	Aftësim teknologjik	164	15
6	Gjuha frënge	520	47
7	Gjuha frënge - fletore pune	416	38
8	Informatikë	177	16
	<b>Klasa e tetë</b>		
1	Gjuha shqipe	396	36
2	Edukata shoqërore	133	12
3	Edukim muzikor	246	22
4	Gjuha frënge	556	51
5	Gjuha frënge - fletore pune	451	41
6	Gjuha italiane	694	63
7	Gjuha italiane - fletore pune	564	51
8	Gjuha angleze për fillestarë (kl. 8 dhe 9)	763	69
9	Gjuha angleze - fl. pune për fill. (kl. 8 dhe 9)	624	57
10	Gjuha frënge për fillestarë (kl. 8 dhe 9)	763	69
11	Gjuha frënge - fl. pune për fill. (kl. 8 dhe 9)	624	57
12	Gjuha italiane për fillestarë (kl. 8 dhe 9)	954	87
13	Gjuha italiane - fl. pune për fill. (kl. 8 dhe 9)	780	71
14	Informatikë	177	16
	<b>Klasa e nëntë</b>		
1	Gjuha shqipe	475	43

2	Edukim muzikor	246	22
3	Historia	277	25
<b>Gjinnazi</b>			
<b>Viti i parë</b>			
1	Gjuhë shqipe dhe Letërsi	507	46
2	Artet (muzika, teatri, vallëzimi, arti pamor)	182	17
3	Qytetari	363	33
4	Edukim për karrierën dhe aftësi për jetën	182	17
<b>Viti i tretë</b>			
1	Letërsi dhe gjuhë shqipe - drejtimi natyror	391	36
2	Letërsi dhe gjuhë shqipe - drejt. shoq. dhe i përgj.	723	66
3	Njohuri për shoqërinë - drejtimi shoqëror	343	31
4	Njohuri për ekonominë - drejt. nat., shoq., i përgjith.	363	33
5	Matematika 3.1 - drejtimi natyror dhe i përgjithshëm	415	38
6	Matematika 3.1 - drejtimi shoqëror	229	21
7	Matematika 3.2 - drejtimi natyror dhe i përgjithshëm	322	29
8	Matematika 3.2 - drejtimi shoqëror	161	15
9	Fizika - drejtimi natyror dhe i përgjithshëm	454	41
10	Fizika - drejtimi shoqëror	200	18
11	Kimia organike - drejtimi natyror dhe i përgjithshëm	442	40
12	Kimia organike - drejtimi shoqëror	318	29
13	Historia - drejtimi natyror	402	37
14	Historia - drejtimi shoqëror dhe i përgjithshëm	575	52
15	Biologjia - drejtimi natyror dhe i përgjithshëm	507	46
16	Biologjia - drejtimi shoqëror	402	37
17	Teknologjia - drejtimi natyror dhe i përgjithshëm	208	19
18	Informatika - drejtimi natyror	427	39
19	Informatika - drejtimi shoqëror dhe i përgjithshëm	427	39
20	Gjeografia - drejtimi natyror, shoqëror, i përgjithshëm	208	19
21	Gjuha frënge - drejt. nat., shoq., i përgjithshëm	713	65
22	Gjuha frënge - fl.pune, drejt.nat., shoq., i përgjith.	619	56
23	Gjuha italiane - drejt. nat., shoq., i përgjithshëm	713	65
24	Gjuha italiane - fl.pune, drejt.nat., shoq., i përgjith.	619	56
25	Gjuha gjermane - drejt. nat., shoq., i përgjithshëm	855	77
26	Gjuha gjermane - fl.pune, drejt.nat., shoq., i përgjith.	785	71
<b>Viti i katërt</b>			
1	Letërsi dhe gjuhë shqipe - drejtimi natyror	224	20
2	Letërsi dhe gjuhë shqipe - drejt. shoq. dhe i përgjith.	641	58
3	Matematika 4.1 - drejtimi natyror dhe i përgjithshëm	428	39
4	Matematika 4.2 - drejtimi natyror dhe i përgjithshëm	286	26
5	Matematika - drejtimi shoqëror	307	28
6	Fizika - drejtimi natyror dhe i përgjithshëm	616	56
7	Fizika - drejtimi shoqëror	295	27
8	Psikologjia - drejtimi shoqëror	254	23
9	Historia - drejtimi natyror	363	33
10	Historia - drejtimi shoqëror dhe i përgjithshëm	616	56
11	Kimia organike - drejtimi natyror dhe i përgjithshëm	469	43
12	Historia e artit - drejtimi shoqëror	363	33
13	Filozofia	156	14
14	Informatika - drejtimi natyror	427	39
15	Informatika - drejtimi shoqëror dhe i përgjithshëm	427	39
16	Biologjia - drejtimi natyror dhe i përgjithshëm	671	61

17	Biologjia - drejtimi shoqëror	496	45
18	Gjeografia - drejtimi nat., shoq., dhe i përgjithshëm	377	34
19	Gjuha frënge - drejt. nat., shoq., i përgjithshëm	763	69
20	Gjuha frënge - fl.pune, drejt.nat., shoq., i përgjith.	681	62
21	Gjuha italiane - drejt. nat., shoq., i përgjithshëm	763	69
22	Gjuha italiane - fl.pune, drejt.nat., shoq., i përgjith.	681	62
23	Gjuha gjermane - drejt. nat., shoq., i përgjithshëm	1041	95
24	Gjuha gjermane - fl.pune, drejt.nat., shoq., i përgjith.	981	89
	<b>Tituj të pakicave kombëtare</b>		
	<b>Tituj të përbashkët të pakicës gre. dhe maqed.</b>		
1	Gjuha shqipe 1	2682	244
2	Gjuha shqipe 2	6691	608
3	Gjuha shqipe 3	14871	1352
4	Gjuha shqipe 4	14871	1352
	<b>Tituj të pakicës greke</b>		
1	Gjuha greke 1	10039	913
2	Gjuha greke 2	17582	1598
3	Gjuha greke 3	20075	1825
4	Gjuha greke 4	20075	1825
5	Gjuha greke 5	20075	1825
6	Gjuha greke 6	20075	1825
7	Gjuha greke 7	16110	1465
8	Gjuha greke 8	16110	1465
9	Gjeografi amtare 8	5852	532
10	Gjuhe greke 9	14871	1352
11	Histori amtare 9	5852	532
	<b>Tituj përkthime në gjuhën greke</b>		
1	Matematika 1	5115	465
2	Matematika 1 - fletë pune	3411	310
3	Edukatë shoqërore 1	2130	194
4	Matematika 2	5116	465
5	Matematika 2 - fletë pune	3425	311
6	Edukata shoqërore 2	2130	194
7	Matematika 3	7674	698
8	Matematika 3 - fletë pune	5115	465
9	Dituri natyre 3	5969	543
10	Edukatë shoqërore 3	2558	233
11	Matematika 4	5369	488
12	Matematika 4 - fletë pune	3222	293
13	Dituri natyre 4	7674	698
14	Edukata shoqërore 4	2479	225
15	Edukim muzikor 4	3098	282
16	Dituri natyre 5	5969	543
17	Edukata shoqërore 5	2479	225
18	Edukata muzikore 5	3098	282
19	Aftësim teknologjik 5	3098	282
20	Biologji dhe edukim shëndetësor 6	4359	396
21	Historia 6	4462	406
22	Gjeografia 6	4462	406
23	Edukata shoqërore 6	1612	147
24	Edukim muzikor 6	1504	137
25	Aftësim teknologjik 6	1504	137

26	Edukim figurativ 6	2253	205
27	Historia 7	5632	512
28	Gjeografia 7	5632	512
29	Biologji dhe edukim shëndetësor 7	5632	512
30	Edukata shoqërore 7	2525	230
31	Edukim figurativ 7	2253	205
32	Edukim muzikor 7	1982	180
33	Aftësim teknologjik 7	2479	225
34	Historia 8	5632	512
35	Gjeografia 8	5632	512
36	Biologji dhe edukim shëndetësor 8	5700	518
37	Edukata shoqërore 8	2168	197
38	Edukim figurativ 8	3098	282
39	Edukim muzikor 8	3098	282
40	Biologji dhe edukim shëndetësor 9	5700	518
41	Edukatë shoqërore 9	2168	197
42	Edukim muzikor 9	3098	282
	<b>Tituj të pakicës maqedonase</b>		
1	Gjuha maqedonase 1	17555	1596
2	Gjuha maqedonase 2	30650	2786
3	Gjuha maqedonase 3	34797	3163
4	Gjuha maqedonase 4	34797	3163
5	Gjuha maqedonase 5	34797	3163
6	Gjuha maqedonase 6	34797	3163
7	Gjuha maqedonase 7	24166	2197
8	Gjuha maqedonase 8	24166	2197
9	Gjeografi amtare 8	6160	560
10	Gjuhe maqedonase 9	22308	2028
11	Histori amtare 9	6160	560
	<b>Tituj përkthime të pakicës maqedonase</b>		
1	Matematika 1	8030	730
2	Matematika 1 - fletë pune	5353	487
3	Edukatë shoqërore 1	3346	304
4	Matematika 2	8014	729
5	Matematika 2 - fletë pune	5369	488
6	Edukata shoqërore 2	3346	304
7	Matematika 3	12045	1095
8	Matematika 3 - fletë pune	8030	730
9	Dituri natyre 3	9369	852
10	Edukatë shoqërore 3	4015	365
11	Matematika 4	12393	1127
12	Matematika 4 - fletë pune	7436	676
13	Dituri natyre 4	12045	1095
14	Edukata shoqërore 4	4015	365
15	Edukim muzikor 4	4015	365
16	Dituri natyre 5	9369	852
17	Edukata shoqërore 5	4015	365
18	Edukata muzikore 5	4015	365
19	Aftësim teknologjik 5	3630	330
20	Biologji dhe edukim shëndetësor 6	6989	635
21	Historia 6	7115	647
22	Gjeografia 6	7115	647

23	Edukata shoqërore 6	2776	252
24	Edukim muzikor 6	2776	252
25	Aftësim teknologjik 6	2776	252
26	Edukim figurativ 6	3606	328
27	Historia 7	9016	820
28	Gjeografia 7	9016	820
29	Biologji dhe edukim shëndetësor 7	9016	820
30	Edukata shoqërore 7	3471	316
31	Edukim figurativ 7	3606	328
32	Edukim muzikor 7	3471	316
33	Aftësim teknologjik 7	3966	361
35	Historia 8	8675	789
36	Gjeografia 8	8799	800
37	Biologji dhe edukim shëndetësor 8	9016	820
38	Edukata shoqërore 8	3098	282
39	Edukim figurativ 8	4808	437
40	Edukim muzikor 8	5453	496
42	Biologji dhe edukim shëndetësor 9	9016	820
43	Edukatë shoqërore 9	3098	282
44	Edukim muzikor 9	5453	496
	<b>Arsimi i mesëm profesional</b>		
	<b>Dega hoteleri - turizëm</b>		
1	Agjenci turistike 4, 5	1901	173
2	Kontabiliteti 3, 4, 5	1895	172
	<b>Dega konfeksione - stilim</b>		
1	Baza qepje 3, 4	2068	188
2	Baza prerje 3, 4	2068	188
3	Merceologji tekstili 4	750	68
4	Anatomi artistike 4	813	74
5	Teknikë vizatimi 4	813	74
6	Stilim veshje 4	813	74
	<b>Dega përpunim druri</b>		
1	Prodhime gjysmë të gatshme 2, 3	2217	202
2	Tharje druri 3, 4	2033	185
3	Teknologjia e prodhimit të mobilieve 4, 5	1923	175
4	Prodhime gjysmë të gatshme 4, 5	2217	202
5	Teknologjia e prodhimeve artistike 3	666	61

 <b>REPUBLIKA E SHQIPËRISË</b> <b>MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS</b> <b>KABINETI I MINISTRIT</b>	<b>SHTËPIA BOTUESE</b>
Nr . _____ Prot    Tiranë, më ____/____/ 2009	Nr . _____ Prot    Tiranë, më ____/____/ 2009

## 9. K O N T R A T Ë

Sot, më datë ..... ..2009, në Tiranë, lidhet kjo kontratë, midis palëve:

**MASH:** Ministria e Arsimit dhe Shkencës (më poshtë e quajtur MASH), e përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm Znj. Antonieta Luli

dhe

**BOTUESIT:** Shtëpia Botuese \_\_\_\_\_ (më poshtë e quajtur BOTUESI), e përfaqësuar nga \_\_\_\_\_

### BAZA LIGJORE E KONTRATËS

Ligji nr.7850, darë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 850 e vijues, Ligji nr. 7952, datë 21.6.1995 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar” i ndryshuar, Ligji Nr. 9380, datë 28.4.2005 “Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të” ; VKM Nr.260, datë 18.04.2007 “Për Botimin, Shtypjen dhe Shpërndarjen e Teksteve Shkollore të Sistemit Arsimor Parauniversitar”, i ndryshuar.

Neni 1

#### Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është sipërmarrja e BOTUESIT për botimin, shpërndarjen dhe shitjen tek nxënësit e shkollave të sistemit arsimor parauniversitar të tekstit “.....” shpallur i miratuar nga MASH nëpërmjet Komisionit të Miratimit të Teksteve Shkollore (KMT) pranë kësaj Ministrie.

Neni 2

#### Të dhënat teknike që duhet të plotësojë teksti

Specifikimet teknike minimale që do të plotësojë teksti në përfundim të procesit të shtypjes janë:

Formati i librit: \_\_\_\_\_

Blloku i librit

Numri i ngjyrave: \_\_\_\_\_

Lloji dhe Gramatura e letrës: \_\_\_\_\_

Kopertina e librit:

Numri i ngjyrave: \_\_\_\_\_

Lloji dhe Gramatura e kartonçinës: \_\_\_\_\_

Lidhja e librit: \_\_\_\_\_

Neni 3

#### Çmimi i tekstit

Çmimi i shitjes me pakicë i tekstit të jetë jo më i lartë se \_\_\_\_\_ lekë.

Neni 4  
**Certifikata e lejes së tekstit**

1. Teksti duhet të ketë fituar Certifikatën e Lejes për t'u futur në tregun e shitjes. Certifikimi i tekstit bëhet nëpërmjet KMT përpara se teksti të shitet dhe përpara se të shpërndahet nga BOTUESI për përzgjedhje nga Komisionet e Përzgjedhjes së Teksteve (KOPT) në shkollat.

2. Botuesi detyrohet që, deri në marrjen e Certifikatës së Lejes për këtë tekst, të plotësojë të gjitha vërejtjet sipas rastit, nëse ka të tilla, të cilat do t'i jepen nga KMT. Certifikata e Lejes është e vlefshme për aq kohë sa janë në fuqi të njëjtat programe lëndore, por jo për më pak se 2 (dy) vjet nga koha në të cilën ato janë vendosur ose janë ndryshuar për herë të fundit, përveç rasteve kur leja e dhënë është shfuqizuar në përputhje me dispozitat e parashikuara në këtë kontratë.

3. Kur teksti kërkohet të ribotohet me ndryshime që e kalojnë 15% të masës së tij, atëherë teksti i nënshtrohet procesit të miratimit dhe certifikimit sikurse çdo tekst tjetër.

Neni 4/1  
**Pulla e certifikimit**

1. Në çdo kopje të tekstit të certifikuar, vendoset pulla e certifikimit, e cila jepet nga MASH-i përkundrejt pagesës, në vlerën e kostos së blerjes nga MASH-i.

2. Kopjet e tekstit që do të futen në treg duhet të kenë pullën e certifikimit të ngjitur në kopertinë.

Neni 5  
**Të drejtat e palëve**

A. MASH-i ka të drejtë:

1. Të përfshijë në sistemin konkurrues edhe tekste të tjera alternative, që përfitojnë miratimin dhe certifikimin përmes KMT.

2. Të kontrollojë herë pas here cilësinë e kopjeve të tekstit të hedhura në qarkullim për të verifikuar përmbushjen e standardeve të miratimit, si dhe në rastin e teksteve të ribotuara, korrigjimet e bëra nga botuesi, sipas vërejtjeve të marra pranë KMT.

3. Të pezullojë qarkullimin e tekstit kur konstaton se botuesi nuk ka përmbushur standardet e miratimit dhe nuk ka bërë korrigjimet e kërkuara nga KMT.

B. BOTUESI ka të drejtë:

1. Të zotërojë, së bashku me autorin/autorët e tekstit, të drejtën ekskluzive të pronësisë intelektuale mbi tekstin dhe si mall në shitje (kopirajtin), e drejtë e rregulluar në kontratën ndërmjet tyre dhe e mbrojtur nga ligjet në fuqi.

2. Ta nxjerrë tekstin në shitje të lirë vetëm nëse, paraprakisht, e ka paraqitur tekstin për përzgjedhje në shkolla dhe ka përmbushur porosinë e shkollave për këtë tekst, sipas gjeografisë së kërkesave, të konfirmuar nga drejtori i shkollës përkatëse.

Neni 6  
**Detyrimet e palëve**

A. MASH-i detyrohet:

1. T'i japë BOTUESIT vërejtjet e sugjerimet e bëra nga vlerësuesit e tekstit, por pa dhënë pikët dhe pa zbuluar identitetin e vlerësuesve, pasi BOTUESI bën kërkesë me shkrim.

2. Të kryejë kontrollin përfundimtar të përmbajtjes dhe të specifikimeve teknike nëpërmjet KMT dhe, në rast të përmbushjes së standardeve, t'i japë BOTUESIT Certifikatën e Lejes, brenda 1 jave nga data që BOTUESI dorëzon kërkesën me shkrim dhe dy kopje të tekstit të shtypur.

3. Të përfshijë tekstin e miratuar në Katalogun e Botimeve Shkollore, pasi të jetë lëshuar Certifikata e Lejes.

4. Të pajisë BOTUESIN me listën e shkollave që mund ta përzgjedhin këtë tekst në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

5. Të marrë masat me shkollat, DAR-et ose ZA-të për funksionimin e rregullt të strukturës së përzgjedhjes së teksteve nga shkollat.

6. Në rastin kur teksti është për shkollat e pakicave kombëtare ose shkollat e mesme profesionale, të marrë masa që shkollat, DAR-et ose ZA-të të kryejnë pagesat ndaj BOTUESIT për tekstet e furnizuara, sipas porosive të shkollave, jo më vonë se 15 tetor, nëse teksti subvencionohet tërësisht nga shteti, dhe jo më vonë se 1 nëntor, nëse teksti subvencionohet pjesërisht nga shteti.

7. Të mos pengojë ose ndalojë me asnjë lloj forme, shitjen ose përdorimin e tekstit nga shkollat me qëllim favorizimin në mënyrë të njëanshme të botuesve të tjerë.

8. Të ndjekë një politikë të barabartë dhe të drejtë me të gjithë botuesit, të cilët do të fitojnë të drejtën e botimit, shtypjes dhe shitjes së tekstit tek nxënësit për përdorim në shkolla.

#### B. BOTUESI detyrohet:

1. Që, me mjetet e tij dhe duke marrë përsipër rrezikun, të prodhojë tekstin dhe ta shesë atë sipas kërkesave të shkollave

a) duke respektuar sistemin e përzgjedhjes së tekstit prej tyre,

b) duke përmbushur porositë e shkollave

c) duke mos u tërhequr nga këto detyrime në asnjë fazë të përmbushjes së tyre.

2. Të mos ia kalojë të drejtat e këtij teksti një botuesi tjetër, pa marrë më parë pëlqimin e MASH, për aq kohë sa Certifikata e Lejes është e vlefshme.

3. Të paraqesë pranë KMT 2 kopje të tekstit të shtypur për verifikimin e cilësisë së përmbajtjes dhe asaj fizike, me qëllim që të marrë certifikatën e lejes. Për të marrë këtë certifikatë, BOTUESI është i detyruar të ketë respektuar në mënyrë të rreptë standardet gjuhësore dhe shkencore, specifikimet teknike sipas nenit 2, çmimin e miratimit sipas nenit 3, si dhe kërkesat e tjera të kësaj kontrate për elementet që duhet të përmbushë çdo kopje e tekstit, të cilat përshkruhen në pikat B6, B8 të nenit 6.

4. Të mos e fusë tekstin në sistemin e përzgjedhjes në shkolla dhe të mos e nxjerrë atë në shitje pa marrë Certifikatën e Lejes.

5. Të mos e çojë tekstin për përzgjedhje në shkolla dhe të mos e nxjerrë atë në shitje pa marrë Certifikatën e re të Lejes, ose nëse nuk zbaton nenet 2 e 3 të kësaj kontrate.

6. Të mos fusë në tekst material reklamues të çdo lloji për veten ose këdo biznes apo veprimtari tjetër.

7. Çdo kopje që del në shitje të përmbushë standardet e cilësisë të parashikuara në Certifikatën e Lejes, kërkesat e neneve 2, 3, 4/1 e 6/B6, 6/B8 të kësaj kontrate, si dhe në rastin e teksteve të ribotuara, të jenë hedhur korrigjimet e bëra nga botuesi, sipas vërejtjeve të marra pranë KMT.

8. Të vendosë ISBN-në, çmimin, barkodin dhe simbolin e BOTUESIT në kopertinën e tekstit dhe të pajisë çdo kopje të tij me pullën me hologramë të certifikimit përpara nxjerrjes së tekstit në treg.

9. Të dërgojë, brenda datës 19 maj 2009, në të gjitha shkollat, nga një kopje të tekstit, titull i ri, për përzgjedhje, pasi të pajiset me Certifikatën e Lejes.

10. Të shesë tekstet e certifikuara në libraritë pranë shkollave përkatëse, në zyrat e Postës Shqiptare, ose në rast nevojë dhe në mjediset e shkollave.

11. Të pranojë porosi nga shkollat për llogari të nxënësve si blerës, për plotësimin e nevojave të vitit të shkollor 2009-2010.

12. Të kryejë shpërndarjen e teksteve drejtpërdrejt në librari, në zyrat e Postës Shqiptare, ose në rast nevojë dhe në mjediset e shkollave, sipas një gjeografie të përcaktuar nga MASH në të gjithë vendin dhe sipas porosive të shkollave. Shpërndarja të përfundojë deri më 15 gusht 2009.

13. Shitja e teksteve shkollore fillon më 16 korrik 2009, duke furnizuar sasinë e plotë të porositur për titull.

14. Të mos e nxjerrë në shitje të lirë tekstin jashtë sistemit konkurrues të përzgjedhjes në shkolla, pa furnizuar nxënësit në librari, në zyrat e Postës Shqiptare, në mjediset e shkollave, me sasi të planifikuara për shkollat, të konfirmuar nga drejtori i shkollës përkatëse.

15. T'u shesë me lekë në dorë nxënësve tekstet e porositura nga shkollat, në librari, zyrat e postës shqiptare apo në mjediset e shkollave, nëpërmjet personave të kontraktuar, sipas gjeografisë së përcaktuar nga MASH-i. Nëse teksti është për shkolla të pakicave kombëtare ose shkolla të mesme profesionale, sasia e teksteve e porositur të çohet në shkollë e shoqëruar me faturën tatimore.

16. Për librat e shitur me lekë në dorë, blerësit t'i lëshojë dokumentin e shitjes ose faturë të kasës fiskale, sipas modelit të caktuar nga Ministria e Financave.

17. Të mos e shesë tekstin si pjesë e ndonjë pakoje (me tekste të tjera, fletore, materiale mësimore etj.), gjë që rrit artificialisht çmimin dhe e detyron konsumatorin të paguajë më shumë.

18. Të mos veprojnë ndryshe nga mënyra e përcaktuar në këtë kontratë për botimin, shtypjen dhe shpërndarjen e tekstit për të cilin ka marrë Certifikatën e Lejes.

19. Te rregulloje me kontrate plotësimin e detyrimeve të mësipërme kur ka te trete.

#### Neni 7

#### **Vlefshmëria e kontratës**

1. Kjo kontratë është e vlefshme për vitin shkollor 2009-2010.

#### Neni 8

#### **Sanksionet**

1. Pas nënshkrimit, kjo kontratë nuk mund të zgjidhet në mënyrë të njëanshme nga BOTUESI. Në rast se kjo ndodh, MASH i lind e drejta të përjashtojë BOTUESIN nga e drejta për të marrë pjesë në sistemin e miratimit të teksteve dhe BOTUESI detyrohet të paguajë të gjithë dëmin që i ka shkaktuar MASH nga prishja e kontratës. Llogaritja e dëmit bëhet nga MASH. Njëkohësisht, kur teksti është me një alternativë, BOTUESI detyrohet që t'ia kalojë, përkundrejt vlefës, të drejtat e botimit, shpërndarjes dhe shitjes së këtij teksti një botuesi tjetër, i cili u nënshtrohet të gjitha detyrimeve të kësaj kontrate për aq kohë sa është e vlefshme Certifikata e Lejes.

2. MASH nuk mund ta zgjidhë këtë kontratë në mënyrë të njëanshme, përveç rasteve kur konstatohen shkeljet dhe mosplotësimi i detyrimeve të botuesit të përmendura në këtë kontratë. Nëse MASH e prish kontratën pa shkaqe të arsyeshme, detyrohet të paguajë të gjithë dëmin që i ka shkaktuar BOTUESIT.

3. Për shkeljet, të paktën të një prej paragrafëve të nenit 6 të kontratës, nga BOTUESI, ai përjashtohet nga e drejta për të paraqitur tekste për miratim në të ardhmen pranë MASH në KMT, për aq kohë sa ta gjykojë MASH. Njëherësh, ai ngarkohet t'i paguajë MASH penalitetin prej 1000000 lekë.

#### Neni 9

#### **Mosmarrëveshjet**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis palëve zgjidhen me mirëkuptim. Në të kundërt, zgjidhja e tyre bëhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës.

#### Neni 10

#### **Të përgjithshme**

Kjo kontratë nënshkruhet në 3 (tri) kopje origjinale, nga të cilat 2 (dy) i merr MASH dhe 1 (një) BOTUESI. Kjo kontratë hyn në fuqi, pasi nënshkruhet nga të dyja palët.

PËR MINISTRINË E ARSIMIT  
DHE SHKENCËS

PËR SHTËPINË BOTUESE

ANTONIETA LULI

## 10. DEKLARATË PËR AUTORËSINË E TEKSTIT

Deklaroj se autorët e tekstit \_\_\_\_\_, dorëzuar për miratim pranë Komisionit të Miratimit të Teksteve në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, janë si më poshtë:

Emri Pjesa e tekstit  
(kapitujt ose thjesht bashkautorësi)

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_
4. \_\_\_\_\_
5. \_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_\_

**BOTUESI**

**Shënim:**

Dorëzohet një kopje me emrin, firmën dhe vulën e botuesit, e mbyllur dhe e dyllosur në zarfin A4 të bardhë e pa shenja të jashtme.

**11. DEKLARATË  
PËR PAJTUESHMËRINË ME RREGULLIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT**

Deklaroj se asnjë prej autorëve, si më poshtë, të tekstit \_\_\_\_\_, dorëzuar për miratim pranë Komisionit të Miratimit të Teksteve në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, nuk është punonjës i MASH-it, i Institutit të Kurrikulës dhe Trajnimit, i ndonjë DAR/ZA-je si dhe as i lidhur me interesa familjare ose financiare me punonjës të këtyre institucioneve:

EMRAT E AUTORËVE

FIRMAT

1. _____	_____
2. _____	_____
3. _____	_____
4. _____	_____
5. _____	_____
_____	_____

Deklaroj po ashtu se Shtëpia Botuese \_\_\_\_\_ nuk është e lidhur me interesa familjare ose financiare me punonjës të këtyre institucioneve.

Data \_\_\_\_\_

BOTUESI

Shënim:

Dorëzohet një kopje me emrin, firmën dhe vulën e botuesit, e mbyllur dhe e dyllosur në zarfin A4 të bardhë e pa shenja të jashtme.

## 12. DEKLARATË PËR KOPIRAJTIMIN E TEKSTIT

Deklaroj se kopirajti i tekstit \_\_\_\_\_, dorëzuar për miratim pranë Komisionit të Miratimit të Teksteve, në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, është në zotërim si më poshtë:

Pjesa e tekstit ose teksti në tërësi	Zotëruesi i kopirajtit	Burimi i kopirajtit
1. _____	_____	_____
2. _____	_____	_____
3. _____	_____	_____
4. _____	_____	_____
5. _____	_____	_____
6. _____	_____	_____
7. _____	_____	_____
8. _____	_____	_____
9. _____	_____	_____
10. _____	_____	_____

Data \_\_\_\_\_

**BOTUESI**

### Shënim:

1. Si pjesë të tekstit për efekt kopirajti, mund të përfshihen edhe ilustrime, ide, punë editoriale. Zotërimi i kopirajtit nga subjekti përkatës duhet të dëshmohet në kontratën përkatëse midis autorëve dhe botuesit ose me dokumente të blerjes apo dhurimit të kësaj të drejte nga të tretë, kopje të noterizuara të të cilave përfshihen bashkëngjitur. Në rastet kur kopirajti është fryt i punës origjinale të vetë subjektit, në kolonën e tretë për burimin e kopirajtit shënohet punë origjinale. Në kolonën e burimit të kopirajtit shënohet, sipas rastit: origjinale, ose nga të tretë (shënohet në kllapa pala e tretë dhe përfshihet dokumenti i blerjes apo dhurimit).

2. Dorëzohet një kopje me emrin, firmën dhe vulën e botuesit, e mbyllur dhe e dyllosur në zarfin A4 të bardhë e pa shenja të jashtme.

### 13. DEKLARATË PËR SPECIFIKIMET TEKNIKE TË TEKSTIT

Deklaroj se specifikimet teknike për tekstin \_\_\_\_\_,  
dorëzuar për miratim pranë Komisionit të Miratimit të Teksteve ,në Ministrinë e Arsimit dhe  
Shkencës, janë si më poshtë:

1. Blloku i librit:

Numri i ngjyrave \_\_\_\_\_

b) Gramatura e letrës (në g/m<sup>2</sup>) \_\_\_\_\_

2. Kopertina e librit:

Numri i ngjyrave \_\_\_\_\_

Gramatura e kartonçinës (në g/m<sup>2</sup>) \_\_\_\_\_

3. Lloji i kartonçinës \_\_\_\_\_

Lloji i lidhjes së librit \_\_\_\_\_

4. Format i librit (në cm) \_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_\_

**BOTUESI**

**Shënim:**

Dorëzohen dy kopje identike, në këtë mënyrë:

1. Një kopje pa emër, pa firmë, pa vulë apo logo të botuesit, si dhe pa shenja që zbulojnë identitetin e botuesit, e mbyllur por jo e dyllosur në zarfin A4 të bardhë e pa shenja të jashtme.

2. Një kopje me emrin, firmën dhe vulën e botuesit, e mbyllur dhe e dyllosur në zarfin A4 të bardhë e pa shenja të jashtme.

#### 14. DEKLARATË PËR ÇMIMIN E TEKSTIT

Deklaroj se çmimi i shitjes së tekstit \_\_\_\_\_,  
dorëzuar për miratim pranë Komisionit të Miratimit të Teksteve, në Ministrinë e Arsimit dhe  
Shkencës, është \_\_\_\_\_ Lekë.  
Me shifra dhe (fjalë)

Data \_\_\_\_\_

BOTUESI

Shënim:

Dorëzohen dy kopje identike, në këtë mënyrë:

1. Një kopje pa emër, pa firmë, pa vulë apo logo të botuesit, si dhe pa shenja që zbulojnë identitetin e botuesit, e mbyllur por jo e dyllosur në zarfin A4 të bardhë e pa shenja të jashtme.
2. Një kopje me emrin, firmën dhe vulën e botuesit, e mbyllur dhe e dyllosur në zarfin A4 të bardhë e pa shenja të jashtme.

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).**  
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 27.3.2009  
Doli nga shtypi më 27.3.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2009

Çmimi 40 lekë